



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 190

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E hënë, 11 nëntor 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 378, datë 5.11.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 20927
Dekret i Presidentit nr. 380, datë 5.11.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 20927
Dekret i Presidentit nr. 384, datë 5.11.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 20927
Dekret i Presidentit nr. 385, datë 5.11.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 20928
Dekret i Presidentit nr. 386, datë 5.11.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 20928
Dekret i Presidentit nr. 387, datë 5.11.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 20928
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 683, datë 6.11.2024	Për miratimin e metodologjisë “Për identifikimin e operatorëve të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit” 20929
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 690, datë 6.11.2024	Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për lidhjen e marrëveshjeve të veçanta të bashkëpunimit midis subjekteve publike shqiptare dhe subjekteve publike dhe/ose private të Emirateve të Bashkuara Arabe, në fusha, projekte dhe programe konkrete..... 20959
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 691, datë 6.11.2024	Për përcaktimin e rregullave të veçanta që zbatohen për kontratën e mësimin të profesionit dhe përcaktimin e pagës minimale për mësimin e profesionit në arsimin dhe formimin profesional në formën e dyfishitë 20963
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 692, datë 7.11.2024	Për emërimin në detyrë të prefektit të qarkut të Fierit..... 20967



DEKRET
Nr. 378, datë 5.11.2024

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Marlon Bashkim Dino
2. Kristi Josif Lubonja
3. Anastas Dhimitri Sidheri
4. Irin Pal Topalli

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 380, datë 5.11.2024

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Andja Arthur Nazifi
2. Andi Ferdinand Hanxhari

3. Erzim Ylli Veshi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 384, datë 5.11.2024

PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohe lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Lindita Rushit Bezhani
2. Daren George Martial Joachim Nourice
3. Ardit Bujar Canka
4. Dajana Astrit Ramadani (Beqja)
5. Persa Andro Gjinoviq (Marashaj)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

**DEKRET****Nr. 385, datë 5.11.2024****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Aleks Risto Martinović
2. Jozef Nikolin Tafili
3. Flavja Astrit Leka
4. Ina Zabit Xite (Nuredini)
5. Oliver Zalo Xite

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 386, datë 5.11.2024****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Aria Juri Hamiti

2. Sara Juri Hamiti

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 387, datë 5.11.2024****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Artur Gilo Mahmutaj
2. Angelos Artur Mahmutaj
3. Pavlin Mark Meci
4. Amela Nikoll Mraja
5. Eraldo Tajar Caushaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**



VENDIM
Nr. 683, datë 6.11.2024

PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË
“PËR IDENTIFIKIMIN E
OPERATORËVE TË
INFRASTRUKTURAVE KRITIKE DHE
TË RËNDËSISHME TË
INFORMACIONIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 12, të ligjit nr. 25/2024, “Për sigurinë kibernetike”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e metodologjisë “Për identifikimin e operatorëve të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

METODOLOGJIA
PËR IDENTIFIKIMIN E OPERATORËVE
TË INFRASTRUKTURAVE KRITIKE DHE
TË RËNDËSISHME TË INFORMACIONIT

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i kësaj metodologjie është mbrojtja e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit nëpërmjet aplikimit të standardeve të sigurisë në të gjithë sektorët e vendit, si dhe standardizimi i proceseve të identifikimit të operatorëve të infrastrukturave kritike e të rëndësishme të informacionit.

2. Objekt i kësaj metodologjie është detajimi i kriterëve dhe përcaktimi i procedurave për identifikimin e kategorizimin e operatorëve të infrastrukturave të informacionit në kritikë dhe të

rëndësishëm, si dhe të shërbimeve të ofruara prej tyre.

3. Metodologjia përcakton vetëm sektorë/shërbime, në përputhje me sektorët/shërbimet e përcaktuar/a në anekset e ligjit nr. 25/2024, “Për sigurinë kibernetike”, dhe që gjejnë rregullim në legjislacionin kombëtar.

4. Termat e përdorur në këtë metodologji kanë të njëjtin kuptim me termat e përcaktuar në ligjin nr. 25/2024, “Për sigurinë kibernetike”, ndërsa termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Varësi kibernetike”, çdo shërbim, i cili ofrohet përmes teknologjisë së informacionit dhe komunikimit;

b) “Skema “OSE”, modeli matematikor, që zbatohet për klasifikimin e shërbimeve si kritikë apo të rëndësishme, bazuar mbi kriteret përkatëse klasifikuese. Për më tepër, shikoni shtojcën nr. 1 të kësaj metodologjie;

c) “Transaksion financiar digjital”, një shkëmbim monetar, që realizohet përmes teknologjive digjitale, duke eliminuar nevojën për ndërveprime fizike dhe dokumente letre. Këto transaksione përfshijnë pagesa *on-line* me karta krediti ose debiti, transferime elektronike të fondeve, përdorimin e portofolave elektronikë dhe shkëmbimin e kriptovalutave e të tjera.

KREU II
HAPAT E IDENTIFIKIMIT DHE TË
KLASIFIKIMIT TË OPERATORËVE,
SHËRBIMEVE/INFRASTRUKTURAVE TË
INFORMACIONIT

Procesi i identifikimit dhe i klasifikimit të operatorëve, shërbimeve dhe infrastrukturave të informacionit kryhet sipas hapave të mëposhtëm:

a) identifikimit të sektorëve dhe nënsektorëve kritikë në nivel kombëtar, sipas anekseve të ligjit nr. 25/2024, “Për sigurinë kibernetike”, të cilët gjejnë rregullim në legjislacionin kombëtar;

b) identifikimit dhe grupimit të operatorëve në nivel kombëtar, që operojnë në secilin sektor/nënsektor, në bashkëpunim me autoritetet rregullatore ose/dhe institucionit përgjegjës, që mban regjistrin tregtar në vend;

c) konsultimit me autoritetet rregullatore dhe operatorët përkatës përmes vetëdeklarimit, si dhe procesit të marrjes së informacioneve të nevojshme për klasifikimin e tyre si kritikë ose të rëndësishme;



ç) identifikimit të shërbimeve në nivel operatori pas konsultimit me operatorët përkatës, përmes vetëdeklarimit, si dhe procesit të marrjes së informacioneve të nevojshme për klasifikimin e tyre si kritike ose të rëndësishme, bazuar në pragje;

d) klasifikimit në shërbimet/infrastrukturat kritike dhe të rëndësishme të informacionit, në përputhje me kriteret e pragjet e përcaktuara në këtë metodologji;

dh) AKSK-ja, pasi kryen procesin e klasifikimit sipas shkronjës “d”, harton listën e operatorëve të infrastrukturave kritike e të rëndësishme të informacionit.

KREU III

KRITERET E PËRGJITHSHME DHE KRITERET E VEÇANTA SEKTORIALE

1. Kriteret për vlerësimin e shërbimeve ndahen në kritere të përgjithshme dhe sektoriale. Në të gjitha rastet, vlerësimi i shërbimeve bazohet në skemën “OSE”, sipas kësaj metodologjie. Në rastet kur shërbimet nuk klasifikohen sipas kriterit bazë, sipas përcaktimeve në pikën 2 të këtij kreu, atëherë këto shërbime do të konsiderohen automatikisht si të paklasifikueshme.

2. Kriteri bazë mbi të cilin kryhet procesi fillestar i klasifikimit të shërbimit të operatorëve të infrastrukturave të informacionit është varësia kibernetike e shërbimit digjital të ofruar. Në rast se shërbimi digjital i ofruar nuk ka varësi kibernetike, atëherë shërbimi nuk klasifikohet për analizë të mëtejshme.

3. Kriteret e përgjithshme sektoriale

3.1 Kriteret e përgjithshme sektoriale kanë peshë specifike më të lartë se ato të quajtura kritere të veçanta sektoriale. Kriteret e përgjithshme sektoriale janë kritere dominante në klasifikim brenda një sektori. Kjo do të thotë që, nëse një shërbim klasifikohet nga kriteret e përgjithshme sektoriale, automatikisht nuk vijohet më tej për analizë me kriteret e veçanta sektoriale. Përjashtim bën rasti kur nga klasifikimi përmes kritereve të përgjithshme sektoriale mbetet i papërcaktuar kritikaliteti i shërbimit.

3.2 Kriteri i përgjithshëm, sipas kësaj metodologjie, përfshin:

- a) jetën dhe shëndetin e qytetarëve;
- b) sigurinë kombëtare dhe rendin publik;
- c) mjedisin;
- ç) efektin financiar;
- d) shërbimin e ofruar unik.

4. Kriteret e veçanta sektoriale

4.1 Kriteret e veçanta sektoriale kanë më pak peshë në përcaktimin e kritikalitetit të shërbimit. Këto kritere janë faza e fundit e klasifikimit të kritikalitetit të shërbimit dhe përcaktohen në bazë të pragjeve të përcaktuara.

5. Shërbimet, të cilat nuk klasifikohen

Sipas kësaj metodologjie, nuk do të klasifikohen si shërbime kritike apo të rëndësishme të informacionit ato shërbime, të cilat, pavarësisht varësisë kibernetike, nuk kanë impakt në jetën dhe shëndetin e qytetarëve, sigurinë kombëtare, rendin publik, mjedis, efekt financiar dhe nuk konsiderohen si një shërbim unik i ofruar.




Figura 1. Skema e hapave të ndjekur për klasifikimin e shërbimeve/infrastrukturave sipas sektorëve

KREU IV

SEKTORËT DHE NËNSEKTORËT NË FUSHËN E SIGURISË KIBERNETIKE SIPAS KRITIKALITETIT TË TYRE

Identifikimi i sektorëve dhe i nënsektorëve, bazuar në kritikalitetin e tyre, është përcaktuar në anekset e ligjit nr. 25/2024, “Për sigurinë kibernetike”, si më poshtë:

Tabela 1. Sektorë me kritikalitet të lartë

Sektori	Nënsektori
Energjia	Elektriciteti
	Ngrohja dhe ftohja qendrore
	Nafta
	Gazi
	Hidrogjeni
Transporti	Ajror
	Hekurudhor
	Detar
	Rrugor



Bankar	
Infrastruktura e tregut financiar	
Shëndetësor	
Subjektet që ofrojnë shërbime ose hostojnë sisteme për përpunimin dhe transmetimin e informacionit të klasifikuar, që lidhen më sigurinë publike	
Furnizimi me ujë të pijshëm	
Ujërat e zeza	
Infrastruktura digjitale	Shërbime elektronike dhe komunikimi
Menaxhimi i shërbimeve TIK (biznes me biznes)	
Administrata publike	
Hapësira	
Sektori arsimor	
Turizmi	

Tabela 2. Sektorë të tjerë kritikë

Sektori	Nënsекtori
Postar dhe shërbimet e korrierit	
Menaxhimi i mbetjeve	
Prodhimi, përpunimi dhe shpërndarja e kimikateve	
Prodhimi, procesimi dhe shpërndarja e ushqimit	
Prodhimi	Prodhimi i pajisjeve mjekësore dhe në pajisje mjekësore diagnostikuese <i>vitro</i>
	Prodhim i produkteve kompjuterike, elektronike dhe optike
	Prodhimi i pajisjeve elektrike
	Prodhim makinerish dhe pajisjesh n.e.c.
	Prodhimi i automjeteve, rimorkiove dhe gjysmërimorkiove
	Prodhimi i pajisjeve të tjera të transportit
Ofruesit e shërbimeve digjitale	

KREU V SEKTORI ENERGJETIK

I. Sektori energjetik

1. Sektori i energjisë është një nga sektorët më të rëndësishëm dhe strategjikë në ekonominë e çdo vendi, duke sjellë një ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik, mirëqenien sociale dhe mjedisin. Sektori i energjisë përfshin të gjitha shërbimet e lidhura me prodhimin, transmetimin, shpërndarjen dhe konsumin e energjisë në forma të ndryshme, si: energjia elektrike, energjia nga burimet fosile (nafta, gazi natyror, qymyri) dhe energjia e rinovueshme (hidroenergji, energjia diellore etj.).

2. Sektori i energjisë përbëhet nga nënsекторët, si më poshtë vijon:

- elektriciteti;
- ngrohja dhe ftohja qendrore;
- nafta;
- gazi;
- hidrogjeni.

Çdo nënsекtor përfshin një gamë të gjerë shërbimesh.

II. Nënsекtori i elektricitetit

1. Nënsекtori i elektricitetit përfshin këto shërbime:

- prodhimin e energjisë elektrike;
- shpërndarjen e energjisë elektrike;
- transmetimin e energjisë elektrike;
- furnizimin me energji, si ai me energji elektrike;

d) shërbimin e Bursës Shqiptare të Energjisë.

2. Klasifikimi, bazuar në kriteret e përgjithshme sektoriale

2.1 Shërbimi i transmetimit të energjisë elektrike klasifikohet automatikisht si shërbim kritik.

2.2 Shërbimi i shpërndarjes së energjisë elektrike klasifikohet automatikisht si shërbim kritik.

2.3 Shërbimi i furnizimit me energji nga shoqëritë e ngarkuara me detyrimin e shërbimit publik klasifikohet automatikisht si shërbim kritik.

2.4 Shërbimi i Bursës Shqiptare të Energjisë klasifikohet automatikisht si shërbim kritik.

2.5 Shërbimi i furnizimit për klientë të lidhur me sistemin e transmetimit dhe të atij të shpërndarjes në tregun e liberalizuar nga shoqëritë, të cilat nuk kanë statusin e mësipërm (të pikës 2.3)¹, klasifikohen automatikisht si shërbime të rëndësishme.

3. Klasifikimi, bazuar në kriteret e veçanta sektoriale dhe pragjet

3.1 Shërbimi i prodhimit të energjisë sipas fuqisë së instaluar (kapacitetit gjenerues) përcaktohet si:

a) shërbim/infrastrukturë e rëndësishme nga 15 mw–100 mw;

b) shërbim/infrastrukturë kritike mbi 100 mw.

Skema




Figura 2. Klasifikimi i shërbimeve të sektorit energjetik – elektriciteti

III. Nënsektori i gazit

1. Nënsektori i gazit përfshin gazin natyror, i cili përbëhet nga gazi metan, përfshirë gazin shoqërues, si dhe të gjitha hidrokarburet, që janë në gjendje të gaztë, në kushte atmosferike normale, i cili përfshin edhe GNL-në, biogazin ose lloje të tjera gazi, që transmetohen e shpërndahen në sistemin e tubacioneve.

2. Nënsektori i gazit përfshin këto shërbime:

a) transmetimin e gazit natyror;

b) shpërndarjen e gazit natyror;

c) furnizimin e gazit natyror;

¹ Shërbimet nga shoqëritë e ngarkuara me detyrimin e shërbimit publik.

ç) tregtimin e gazit natyror;

d) operimin në hapësirat e depozitimit të gazit natyror;

dh) operimin në impiantet e GNL-së.

3. Klasifikimi, bazuar në kriteret e përgjithshme sektoriale

3.1 Shërbimi i transmetimit të gazit natyror klasifikohet automatikisht si shërbim kritik.

3.2 Shërbimi i shpërndarjes së gazit natyror klasifikohet automatikisht si shërbim kritik.

3.3 Shërbimi i furnizimit të gazit natyror klasifikohet automatikisht si shërbim kritik.

3.4 Shërbimi i tregtimit të gazit natyror klasifikohet automatikisht si shërbim kritik.

3.5 Shërbimi i operimit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror klasifikohet automatikisht si shërbim kritik.

3.6 Shërbimi i operimit në impiantet e GNL-së klasifikohet automatikisht si shërbim kritik.

4. Për nënsektorin e gazit nuk aplikohen kriteret e veçanta sektoriale.

Skema

Kriteret e Përgjithshme Sektoriale




Figura 3. Klasifikimi i shërbimeve të sektorit energjetik – gaz

IV. Nënsektori i naftës

1. Nënsektori i naftës përfshin shërbimet, si më poshtë vijon:

a) shërbimin e prodhimit të naftës;

b) shërbimin e përpunimit të naftës;

c) shërbimin e transportimit të naftës;

ç) shërbimin e depozitimit të naftës;

d) shërbimin e tregtimit të naftës;

dh) shërbimin e transmetimit të naftës.

2. Klasifikimi, bazuar në kriteret e përgjithshme sektoriale

2.1 Shërbimi i prodhimit të naftës klasifikohet automatikisht si shërbim kritik.

2.2 Shërbimi i përpunimit të naftës klasifikohet automatikisht si shërbim kritik.

2.3 Shërbimi i transportimit të naftës klasifikohet automatikisht si shërbim kritik.


2.4 Shërbimi i depozitimit të naftës klasifikohet automatikisht si shërbim kritik.

2.5 Shërbimi i tregtimit të naftës klasifikohet automatikisht si shërbim kritik.

2.6 Shërbimi i transmetimit të naftës klasifikohet automatikisht si shërbim kritik.

3. Për nënsektorin e naftës nuk aplikohen kriteret e veçanta sektoriale.

Skema

Kriteret e Përgjithshme Sektoriale*Figura 4. Klasifikimi i shërbimeve të sektorit energjetik – nafta*

KREU VI

SEKTORI I TRANSPORTIT

I. Nënsektori i transportit ajror

1. Nënsektori i transportit ajror është një komponent kritik i infrastrukturës globale, duke ofruar lidhje të shpejta dhe efikase ndërmjet vendeve dhe kontinenteve. Ai përfshin një rrjet të gjerë aeroportesh, linjash ajrore dhe avionësh modernë, që lejojnë transportin e shpejtë të pasagjerëve dhe të mallrave. Ky sektor është jetësor për ekonominë globale, duke mbështetur turizmin, tregtinë ndërkombëtare dhe bizneset e shumta. Përparimet teknologjike dhe përmirësimet e vazhdueshme në siguri dhe shërbime kanë bërë që transporti ajror të jetë më i qasshëm dhe i besueshëm për një numër të madh njerëzish në mbarë botën.

2. Nënsektori i transportit ajror përfshin këto shërbime:

- a) shërbimin e lundrimit ajror;
- b) shërbimin e transporti ajror të pasagjerëve;
- c) shërbimin e transportimi ajror të mallrave/postës;
- ç) shërbimi aeroportual të udhëtarëve dhe të mallrave.

3. Klasifikimi, bazuar në kriteret e përgjithshme sektoriale:

3.1 Shërbimi i lundrimit ajror, klasifikohet automatikisht si shërbim kritik.

3.2 Shërbimi i transportit ajror të pasagjerëve, klasifikohen automatikisht si shërbim kritik.

3.3 Shërbimi i transportimit ajror të mallrave të klasifikuara si të rrezikshme², si dhe biologjike, biokimike, nukleare dhe radioaktive³ klasifikohet automatikisht si shërbim kritik.

4. Klasifikimi, bazuar në kriteret e veçanta sektoriale dhe pragjet:

4.1 Shërbimet aeroportuale të lidhura me udhëtarët përcaktohen sipas:

- a) numrit të fluturimeve në vit, referuar vitit paraardhës:
 - i. shërbim/infrastrukturë e rëndësishme nga 500–3,000 fluturime/vit;
 - ii. shërbim/infrastrukturë kritike mbi 3,000 fluturime/vit.
- b) numrit vjetor të udhëtarëve të regjistruar nga viti paraardhës:
 - i. shërbim/infrastrukturë e rëndësishme nga 100,000–600,000 udhëtarë/vit;
 - ii. shërbim/infrastrukturë kritike mbi 600,000 udhëtarë/vit.

² <https://www.transport-community.org/transport-of-dangerous-goods/>

³ https://cbrn-risk-mitigation.network.europa.eu/index_en

5. Nuk klasifikohen si shërbime kritike dhe të rëndësishme shërbimet e sektorit të transportit ajror, si më poshtë vijon:

5.1 Shërbimi i transportimit ajror të mallrave;

5.2 Shërbimi i transportimit ajror të postës.

Skema




Figura 5. Klasifikimi i shërbimeve të sektorit të transportit – ajror

II. Nënsektori i transportit hekurudhor

1. Nënsektori i transportit hekurudhor është një pjesë thelbësore e infrastrukturës transportuese, duke ofruar një mënyrë të qëndrueshme dhe efikase për transportimin e pasagjerëve dhe të mallrave mbi distanca të gjata. Ky sektor përfshin rrjete të gjera hekurudhore, stacione trenash dhe trena modernë, që përdoren për udhëtime ndërqytetëse dhe ndërkombëtare. Transporti hekurudhor është i njohur për kapacitetin e tij të lartë të ngarkesës, duke e bërë atë një alternativë ekologjike ndaj transportit rrugor e ajror.

2. Nënsektori i transportit hekurudhor përfshin këto shërbime:

- a) shërbimin e administrimit të infrastrukturës hekurudhore;
- b) shërbimin e operimit të trafikut dhe të ndërveprimit ndërmjet sipërmarrësve hekurudhorë dhe administruesve të infrastrukturës;
- c) shërbimin e transportit të udhëtarëve;
- ç) shërbimin e transportimit të mallrave;
- d) shërbimin e transportimit të tërheqjes së mjeteve hekurudhore.

3. Klasifikimi, bazuar në kriteret e përgjithshme sektoriale:

3.1 Shërbimi i administrimit të infrastrukturës hekurudhore i ofruar nga operatori kombëtar klasifikohet automatikisht si shërbim kritik.

3.2 Shërbimi i transportit të udhëtarëve përmes sistemit hekurudhor klasifikohet automatikisht si shërbim kritik.

3.3 Shërbimi i transportimit të mallrave të klasifikuara si të rrezikshme⁴ përmes sistemit hekurudhor klasifikohet automatikisht si shërbim kritik.

⁴ <https://hekurudha.al/baza-ligjore/>

3.4 Shërbimi i transportimit të mallrave të klasifikuara si jo të rrezikshme⁵ përmes sistemit hekurudhor klasifikohet automatikisht si shërbim i rëndësishëm.

3.5 Shërbimi i transportimit të tërheqjes së mjeteve hekurudhore klasifikohet i rëndësishëm.

4. Për nënsektorin e transportit hekurudhor nuk aplikohen kriteret e veçanta sektoriale.

5. Nuk klasifikohen si shërbime kritike dhe të rëndësishme shërbimet e sektorit të transportit hekurudhor, si më poshtë vijon:

5.1 Shërbimi i operimit të trafikut dhe të ndërveprimit ndërmjet sipërmarrësve hekurudhorë dhe administruesve të infrastrukturës.

Skema




Figura 6. Klasifikimi i shërbimeve të sektorit të transportit – hekurudhor

III. Nënsektori i transporti detar

1. Nënsektori i transportit detar është një shtyllë kryesore e tregtisë ndërkombëtare, duke ofruar një mënyrë efektive dhe ekonomike për transportimin e mallrave të mëdha dhe të rënda përmes oqeanëve dhe deteve. Ky nënsektor përfshin një flotë të gjerë anijesh tregtare, porte të avancuara dhe rrjete logjistike komplekse, që lehtësojnë lëvizjen globale të mallrave. Transporti detar është i njohur për kapacitetin e tij të lartë dhe kosto-efikasitetin, duke bërë të mundur që vende të ndryshme të importojnë e të eksportojnë sasi të mëdha produktesh me kosto të ulët. Përparimet në teknologjinë e navigimit dhe standardet e sigurisë kanë përmirësuar efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e këtij sektori, duke kontribuar në rritjen e ekonomive globale dhe në zhvillimin e tregtisë ndërkombëtare.

2. Nënsektori i transportit detar përfshin këto shërbime:

- a) shërbimin e transportit detar të mallrave dhe të njerëzve;
- b) shërbimet portuale;
- c) shërbimet e monitorimit të autoriteteve portuale.

3. Klasifikimi, bazuar në kriteret e përgjithshme sektoriale

3.1 Shërbimi i transportimit detar të udhëtarëve klasifikohet automatikisht si shërbim kritik.

3.2 Shërbimi i transportimit detar të mallrave të klasifikuar, si: kimike, biologjike, nukleare dhe radioaktive⁶ klasifikohet automatikisht si shërbim kritik.

⁵ <https://hekurudha.al/baza-ligjore/>

⁶ https://cbrn-risk-mitigation.network.europa.eu/index_en

3.3 Shërbimi i transportimit detar të mallrave të klasifikuara jo të rrezikshme klasifikohet si shërbim i rëndësishëm.

3.4 Shërbimet e monitorimit të autoriteteve portuale klasifikohen automatikisht si shërbim i rëndësishëm.

4. Klasifikimi, bazuar në kriteret e veçanta sektoriale dhe pragjet

4.1 Shërbimet portuale të lidhura direkt/indirekt me qytetarin/biznesin, përcaktohen si më poshtë vijon:

a) numri vjetor i udhëtarëve detarë të regjistruar nga viti paraardhës përcaktohen, si:

i. shërbim/infrastrukturë e rëndësishme nga 100,000–700,000 udhëtarë/vit;

ii. shërbim/infrastrukturë kritike mbi 700,000 udhëtarë/vit;

b) sasia vjetore e mallrave të përpunuara në tonë nga viti paraardhës përcaktohen si:

i. shërbim/infrastrukturë e rëndësishme nga 1–3 milionë tonë;

ii. shërbim/infrastrukturë kritike mbi 3 milionë tonë;

Skema




Figura 7. Klasifikimi i shërbimeve të sektorit të transportit – detar

IV. Nënsektori i transportit rrugor

1. Nënsektori i transportit rrugor është një element kyç i infrastrukturës kombëtare dhe ndërkombëtare, duke siguruar lëvizjen e mallrave dhe të pasagjerëve përmes një rrjeti të gjerë rrugësh e autostradash. Ky nënsektor përfshin automjete të ndryshme, si: kamionë, autobusë dhe makina personale, që mundësojnë transportin fleksibël e të shpejtë brenda dhe midis qyteteve. Përmirësimet në infrastrukturë, teknologjitë e reja të automjeteve dhe masat e sigurisë rrugore kanë ndihmuar në rritjen e efikasitetit, qëndrueshmërisë dhe sigurisë në këtë sektor, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe mobilitetin e popullsisë.

2. Nënsektori i transportit rrugor përfshin këto shërbime:

a) shërbimin e menaxhimit të transportit urban dhe interurban të udhëtarëve;

b) shërbimin për menaxhimin e monitorimin e trafikut rrugor;

c) shërbimin e transportit rrugor të mallrave;

ç) shërbimin e ofruar nga operatorët e sistemeve inteligjente të transportit.

3. Klasifikimi, bazuar në kriteret e përgjithshme sektoriale

3.1 Shërbimi për menaxhimin e monitorimin e trafikut rrugor klasifikohet automatikisht si shërbim kritik.

3.2 Shërbimi i transportit rrugor të mallrave të klasifikuara si të rrezikshme klasifikohet automatikisht si shërbim kritik.

3.3 Shërbimi i ofruar nga operatorët e sistemeve inteligjente të transportit klasifikohet automatikisht si shërbim kritik.

3.4 Shërbimi i menaxhimit të transportit urban dhe interurban të udhëtarëve klasifikohet automatikisht si shërbim i rëndësishëm.

4. Për nënsektorin e transportit rrugor nuk aplikohen kriteret e veçanta sektoriale.

5. Nuk klasifikohen si shërbime kritike dhe të rëndësishme shërbimet e sektorit të transportit rrugor, si më poshtë vijon:

5.1 Shërbimi i transportit rrugor të mallrave të klasifikuara si jo të rrezikshme.

Skema




Figura 8. Klasifikimi i shërbimeve të sektorit të transportit – rrugor

KREU VII SEKTORI FINANCIAR

I. Sektori bankar

1. Sektori bankar është një shtyllë jetike e ekonomisë globale, duke ofruar shërbime financiare që përfshijnë depozitat, kreditë dhe menaxhimin e pasurisë për individët e bizneset. Bankat mundësojnë qarkullimin e kapitalit, si dhe mbështetjen e investimeve dhe të konsumit. Përmes një game të gjerë produktesh e shërbimesh financiare, sektori bankar luan një rol kyç në stabilitetin ekonomik, rritjen ekonomike dhe zhvillimin e infrastrukturës financiare. Inovacionet teknologjike, si bankingu elektronik dhe *mobile* kanë përmirësuar aksesin dhe efikasitetin e shërbimeve bankare, duke i bërë ato më të prekshme dhe më të sigurta për një gamë të gjerë klientësh. Sektori financiar bankar, me autoritet licencues dhe mbikëqyrës Bankën e Shqipërisë⁷, përfshin, si më poshtë vijon:

a) bankat;

⁷ https://www.bankofalbania.org/Stabiliteti_Financiar/Treguesit_e_stabilitetit_financiar/Struktura_e_sektorit_financiar/



- b) subjektet financiare jobanka;
- c) institucionet e parasë elektronike;
- ç) shoqëri të kursim-kreditit dhe unionet e tyre.

2. Sektori bankar përfshin këto shërbime:

- a) shërbimet bankare/financiare, duke përfshirë:
 - i. depozitat monetare;
 - ii. kredidhënien, faktoringun dhe financimin e transaksioneve tregtare, qiranë financiare;
 - iii. shërbimin e pagesave dhe të transferimit të parave;
 - iv. ofrimin e garancive dhe marrjen e angazhimeve;
 - v. këmbimin valutor;
 - vi. instrumentet e tregut të parasë;
 - vii. letrat me vlerë të transferueshme;
 - viii. emetimin e të gjitha llojeve të letrave me vlerë;
 - ix. emetimin e administrimin e instrumenteve të pagesës, përfshirë edhe emetimin e parasë elektronike.
- b) shërbimet e ofruara nga institucionet financiare jobankare;
- c) shërbimet e ofruara nga institucionet e parasë elektronike;
- ç) shërbimet e ofruara nga shoqëritë e kursim-kreditit.

3. Klasifikimi, bazuar në kriteret e përgjithshme sektoriale.

3.1 Shërbimi bankar i lidhur me depozitën e qytetarit klasifikohet automatikisht si shërbim kritik.

3.2 Shërbimet e institucioneve financiare jobankare të lidhura me publikun ose biznesin klasifikohen si shërbime të rëndësishme ose të paklasifikueshme, sipas kriterëve të veçanta sektoriale në vijim.

3.3 Shërbimet e shoqërive të kursim-kreditit klasifikohen si shërbime të rëndësishme ose të paklasifikueshme, sipas kriterëve të veçanta sektoriale në vijim.

3.4 Nëse institucioni financiar nuk kryen transaksione financiare digjitale⁸ për publikun ose biznesin, atëherë shërbimi klasifikohet sipas kriterëve të veçanta sektoriale si shërbim/ infrastrukturë e rëndësishme për vendin ose e paklasifikueshme.

4. Klasifikimi, bazuar në kriteret e veçanta sektoriale dhe pragjet

4.1 Shërbimet e ofruara për klientët dhe bizneset nga institucionet e mëposhtme, si:

- a) bankat;
- b) subjekte financiare jobankare;
- c) institucionet e parasë elektronike;
- ç) shoqëri të kursim-kreditit dhe unionet e tyre;

klasifikohen sipas kriterëve të veçanta sektoriale dhe pragjeve, si më poshtë vijon:

4.1.1 Numri i klientëve aktivë të regjistruar në sistemet e operatorit (në formë direkte ose indirekte⁹) përcaktohet, si:

- a) shërbim/infrastrukturë e rëndësishme nga 5.000–50.000 klientë;
- b) shërbim/infrastrukturë kritike mbi 50.000 klientë.

⁸ Transaksionet financiare digjitale janë veprime të kryera nëpërmjet teknologjive digjitale, që përfshijnë shkëmbimin e parave ose të aseteve të tjera financiare.

⁹ Indirekt vjen nga baza e të dhënave të klientëve të operatorëve të tjerë që bashkëveprojnë.

Skema




Figura 9. Klasifikimi i sektorit bankar

II. Sektori i infrastrukturës së tregjeve financiare

1. Tregjet financiare janë platforma, ku ndodhin transaksionet e aseteve financiare, siç janë aksionet, obligacionet, mallrat dhe valutat. Ato ndihmojnë në përmbushjen e kërkesës dhe të ofertës për këto asete, duke lejuar që paratë të rrjedhin nga ata që kanë tepëri (investitorët) tek ata që kanë nevojë (kompanitë dhe qeveritë).

2. Sektori i tregjeve financiare përfshin këto shërbime:

- në tregun e sigurimeve: shoqëritë e sigurimit, shoqëritë e risigurimit, agjent dhe *broker* në sigurime, vlerësues dëmsh, aktuar i autorizuar;
- në tregun e titujve: shoqëri komisionere, regjistër dhe treg i rregulluar (bursa);
- në tregun e fondeve të pensioneve vullnetare: shoqëri administruese e fondeve të pensionit vullnetar, fond pensioni vullnetar, depozitar i fondeve të pensionit vullnetar;
- në tregun e sipërmarrjeve të investimeve kolektive: shoqëri administruese e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, fond investimi, shoqëri investimi, fonde investimi alternative, depozitar i sipërmarrjeve të investimeve kolektive;
- institucionet e pagesave;
- ofruesit e tjerë të shërbimit të pagesave.

3. Klasifikimi, bazuar në kriteret e përgjithshme sektoriale

3.1 Shërbimet e tregut të titujve (bursës kombëtare) klasifikohen automatikisht si shërbim i rëndësishëm.

3.2 Shërbimet e tregut të sigurimeve klasifikohen automatikisht si shërbim i rëndësishëm.

3.3 Shërbimi i tregut të fondeve të pensioneve vullnetare klasifikohet si shërbim i rëndësishëm ose i paklasifikueshëm, sipas kriterëve të veçanta sektoriale në vijim.

3.4 Shërbimi i tregut të sipërmarrjeve të investimeve kolektive klasifikohet si shërbim i rëndësishëm ose i paklasifikueshëm, sipas kriterëve të veçanta sektoriale në vijim.

4. Klasifikimi, bazuar në kriteret e veçanta sektoriale dhe pragjet

4.1 Shërbimi i tregut të fondeve të pensioneve vullnetare ose i tregut të sipërmarrjeve të investimeve kolektive përcaktohet sipas kriterit të mëposhtëm:

a) numri i klientëve aktivë të regjistruar, që përfitojnë shërbimin (në formë direkte ose indirekte¹⁰) me mbi 5.000 klientë, klasifikohet si shërbim/infrastrukturë e rëndësishme.

4.2 Shërbimet e ofruara nga institucionet e pagesave, shërbimet e ofruara nga ofruesit e tjerë të shërbimit të pagesave klasifikohen sipas kriterëve të veçanta sektoriale dhe pragjeve, si më poshtë vijon:

a) numri i klientëve aktivë të regjistruar në sistemet e operatorit (në formë direkte ose indirekte) përcaktohet, si:

i. shërbim/infrastrukturë e rëndësishme nga 5.000–50.000 klientë;

ii. shërbim/infrastrukturë kritike mbi 50.000 klientë.

Skema




Figura 10. Klasifikimi i sektorit të infrastrukturave të tregjeve financiare

KREU VIII SEKTORI SHËNDETËSOR

1. Sektori shëndetësor është një komponent i rëndësishëm i shoqërisë, i dedikuar për përmirësimin e shëndetit dhe të mirëqenies së individëve përmes ofrimit të shërbimeve mjekësore, trajtumeve dhe kujdesit parandalues. Ky sektor përfshin spitale, klinika, institucione kërkimore, profesionistë të kujdesit shëndetësor dhe teknologji mjekësore, që punojnë së bashku për të diagnostikuar, trajtuar e parandaluar sëmundjet. Sektori shëndetësor luan një rol kyç në ruajtjen e shëndetit publik, përballimin e emergjencave shëndetësore dhe mbështetjen e një shoqërie të shëndetshme dhe produktive.

2. Sektori shëndetësor përfshin këto shërbime:

a) shërbimin e kujdesit shëndetësor parësor;

¹⁰ Indirekt vjen nga baza e të dhënave të klientëve të operatorëve të tjerë që bashkëveprojnë.



- b) shërbimin e kujdesit spitalor;
- c) shërbimin e urgjencës mjekësore;
- ç) shërbimin e shëndetit publik;
- d) shërbimin stomatologjik;
- dh) shërbimin farmaceutik të prodhimit, shpërndarjes, tregimit e kontrollit të barnave;
- e) shërbimin e transfuzionit të gjakut;
- ë) shërbimin për transplantimin e indeve, të qelizave dhe të organeve;
- f) shërbimin laboratorik.

3. Klasifikimi, bazuar në kriteret e përgjithshme sektoriale

3.1 Shërbimi i lidhur me qytetarët në institucionet e kujdesit shëndetësor parësor¹¹ klasifikohet automatikisht si shërbim kritik.

3.2 Shërbimi i lidhur me qytetarët në institucionet shëndetësore publike me shtretër¹² klasifikohet automatikisht si shërbim kritik.

3.3 Shërbimi i lidhur me qytetarët në monitorimin e kontrollin në Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore klasifikohet automatikisht si shërbim kritik.

3.4 Shërbimi i Shëndetit Publik në Institutin e Shëndetit Publik dhe në njësitë e kujdesit shëndetësor, që përgjigjen për sigurinë shëndetësore, survejancën e sëmundjeve, identifikimin e patogjeneve të rrezikshme, impaktin e mjedisit në shëndet etj., klasifikohet automatikisht si shërbim kritik.

3.5 Shërbimet e lidhura me prodhuesit e medikamenteve shëndetësore klasifikohen automatikisht si shërbim kritik.

3.6 Shërbimi i transfuzionit të gjakut klasifikohet automatikisht si shërbim kritik.

3.7 Shërbimet e lidhura me analizat gjenetike në laboratorët mjekësorë klasifikohen automatikisht si shërbim kritik.

3.8 Shërbimet e lidhura me laboratorët *in-vitro* klasifikohen automatikisht si shërbim kritik.

3.9 Shërbimi i Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore me anë të qendrës së kontrollit të barnave dhe pajisjeve mjekësore klasifikohet automatikisht si shërbim kritik.

3.10 Shërbimi për transplantimin e indeve, të qelizave dhe të organeve klasifikohet automatikisht si shërbim kritik.

3.11 Shërbimi i menaxhimit të depove farmaceutike klasifikohet automatikisht si shërbim i rëndësishëm.

4. Klasifikimi, bazuar në kriteret e veçanta sektoriale dhe pragjet

4.1 Shërbimet shëndetësore për qytetarët të ofruara nga institucionet private përcaktohen sipas:

a) numrit të pacientëve të regjistruar, të cilët kanë përfituar shërbimin për vitin paraardhës:

i. shërbim/infrastrukturë e rëndësishme nga 5000–15,000 pacientë;

ii. shërbim/infrastrukturë kritike mbi 15,000 pacientë.

b) numrit të analizave/ekzaminimeve mjekësore të kryera në laborator për vitin paraardhës:

i. shërbim/infrastrukturë e rëndësishme nga 50,000–150,000 analiza/ekzaminime.

ii. shërbim/infrastrukturë kritike mbi 150,000 analiza/ekzaminime.

5. Nuk klasifikohen si shërbime kritike dhe të rëndësishme shërbimet e sektorit shëndetësor, si më poshtë:

5.1 Shërbimi farmaceutik i tregimit me pakicë të barnave;

5.2 Shërbimi stomatologjik.

¹¹ Qendrat shëndetësore, 4 poliklinika të specialiteteve në Tiranë.

¹² Të gjitha spitalet, që kanë brenda dhe poliklinikat e rretheve.



Skema




Figura 11. Klasifikimi i shërbimeve të sektorit të shëndetësisë

KREU IX

SEKTORI I FURNIZIMIT ME UJË TË PIJSHËM

I. Sektori i furnizimit me ujë të pijshëm

1. Sektori i ujit të pijshëm është një element thelbësor për shëndetin publik dhe zhvillimin ekonomik, duke siguruar furnizimin dhe shpërndarjen e ujit të sigurt e të pastër për konsum njerëzor. Ky sektor përfshin infrastrukturën e burimeve ujore, trajtimin e shpërndarjen e ujit dhe menaxhimin e sistemeve të kanalizimeve dhe ujërave të zeza. Teknologjitë e avancuara dhe praktikët e menaxhimit të qëndrueshëm kanë bërë të mundur përmirësimin e cilësisë së ujit dhe reduktimin e ndotjes, duke mbrojtur burimet natyrore dhe shëndetin e popullsisë. Furnizimi i vazhdueshëm me ujë të pijshëm të pastër është jetësor

për parandalimin e sëmundjeve të transmetuara përmes ujit dhe për garantimin e një cilësie të lartë të jetës për komunitetet anembanë botës.

2. Sektori i furnizimit me ujë të pijshëm përfshin këto shërbime:

- shërbimin e grumbullimit dhe trajtimit të ujit të pijshëm;
- shërbimin e shpërndarjes së ujit të pijshëm;
- shërbimin e monitorimit të brendshëm e të jashtëm të verifikimit të cilësisë së ujit të pijshëm.

3. Klasifikimi, bazuar në kriteret e përgjithshme sektoriale

3.1 Shërbimi i monitorimit të verifikimit të cilësisë së ujit të pijshëm klasifikohet automatikisht si shërbim kritik.

4. Klasifikimi, bazuar në kriteret e veçanta sektoriale dhe pragjet

4.1 Shërbimi i shpërndarjes, grumbullimit dhe trajtimit të ujit të pijshëm identifikohet e klasifikohet, si më poshtë:

a) numri i abonentëve në nivel rajonal, që përfitojnë shërbimin, përcaktohet, si:

- shërbim/infrastrukturë e rëndësishme nga 30,000–70,000 abonentë;
- shërbim/infrastrukturë kritike mbi 70,000 abonentë.

Skema




Figura 12. Klasifikimi i shërbimeve të sektorit të furnizimit me ujë të pijshëm

KREU X SEKTORI I UJËRAVE TË ZEZA

I. Sektori i ujërave të zeza

1. Sektori i ujërave të zeza është një komponent kyç i infrastrukturës publike, që përfshin mbledhjen, transportin, trajtimin dhe asgjësimin e ujërave të ndotura nga banesat, bizneset dhe industria. Ky sektor operon për të siguruar që ujërat e zeza të trajtohen në mënyrë të sigurt dhe efikase për të parandaluar ndotjen e mjedisit dhe për të mbrojtur shëndetin publik. Përmes një rrjeti të gjerë kanalizimesh, impianteve të trajtimit dhe teknologjive të avancuara, sektori i ujërave të zeza rikuperon dhe pastron ujërat, duke i bërë ato të përshtatshme për t'u rihedhur në natyrë ose për t'u ripërdorur. Menaxhimi efektiv i këtij sektori është esencial për qëndrueshmërinë mjedisore, ruajtjen e burimeve ujore dhe mirëqenien e komuniteteve.

2. Sektori i ujërave të zeza përfshin këto shërbime:

- a) shërbimin e grumbullimit dhe largimit të ujërave të ndotura;
- b) shërbimin e përpunimit të ujërave të ndotura.

3. Klasifikimi, bazuar në kriteret e përgjithshme sektoriale

3.1 Shërbimi për grumbullimin, largimin dhe përpunimin e ujërave të ndotura klasifikohet automatikisht si shërbim kritik.

4. Për sektorin e ujërave të zeza nuk aplikohen kriteret e veçanta sektoriale.

Skema




Figura 13. Klasifikimi i shërbimeve të sektorit të ujërave të zeza

KREU XI

SEKTORI I INFRASTRUKTURËS DIGJITALE

I. Sektori i infrastrukturës digjitale

1. Sektori i infrastrukturës digjitale është themeli mbi të cilin ndërtohen shërbimet moderne të komunikimit dhe teknologjisë së informacionit, duke mundësuar lidhjen dhe shkëmbimin e të dhënave në mënyrë të shpejtë e të besueshme. Ky sektor përfshin rrjete të gjera telekomunikacioni, kabllot nëndetare, satelitët, qendrat e të dhënave dhe pajisjet e IT-së, që mbështesin internetin dhe komunikimin global. Infrastruktura digjitale është kritike për funksionimin e ekonomive moderne, duke mbështetur gjithçka, nga komunikimi dhe edukimi, deri te tregtia elektronike dhe shërbimet publike.

2. Nënsektori i shërbimeve elektronike dhe komunikimit përfshin:

- a) shërbimet e ofruara nga ofruesit e pikës së shkëmbimit të internetit (*internet exchange point*);
- b) shërbimet DNS, duke përfshirë operatorët e serverëve të emrave rrënjë (*root name servers*);
- c) shërbimet e ofruara nga operatorët e regjistrave të emrave TLD;
- ç) shërbimet kompjuterike në renë kompjuterike (*cloud computing*);
- d) shërbimet e ofruara nga ofruesit e qendrës së të dhënave (*data centre service providers*);
- dh) shërbimet e ofruara nga ofruesit e rrjetit të shpërndarjes së përmbajtjes;
- e) shërbimet e ofruara nga ofruesit e kualifikuar të shërbimeve të besuara;
- ë) shërbimet e ofruesve të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike;
- f) shërbimet e komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun;
- g) shërbimet audio dhe audiovizive të disponueshme për publikun.

3. Klasifikimi, bazuar në kriteret e përgjithshme sektoriale

3.1 Shërbimet e ofruara nga operatorët e regjistrave të emrave TLD klasifikohen automatikisht si shërbim kritik.

3.2 Shërbimi kompjuterik në renë kompjuterike (*“cloud/on-premise hosting”*) i ofruar për hostimin e shërbimeve kritike ose/dhe të rëndësishme të informacionit klasifikohet automatikisht si shërbim kritik.

3.3 Shërbimi i ofruar nga ofruesit e rrjetit publik të komunikimeve elektronike për infrastrukturat kritike dhe të rëndësishme klasifikohet automatikisht si shërbim kritik.

3.4 Shërbimi i ofruar nga operatorët e shërbimit të rrjeteve të komunikimeve elektronike me fuqi të ndjeshme në treg¹³ për subjekte ose klientë fundorë klasifikohet automatikisht si shërbim kritik.

¹³ Referencë: ligji nr. 9918, datë 19.5.2008 (i ndryshuar).

3.5 Shërbimet e ofruara nga ofruesit e kualifikuar të shërbimeve të besuara (OKSHB) klasifikohen automatikisht si shërbime kritike.

3.6 Shërbimet DNS, duke përjashtuar operatorët e serverëve të emrave rrënjë (*root name servers*), klasifikohen si kritike.

3.7 Shërbimet audio dhe audiovizive¹⁴ të ofruara nga operatorë të kategorizuar si kombëtarë klasifikohen automatikisht si shërbim i rëndësishëm.

4. Klasifikimi, bazuar në kriteret e veçanta sektoriale dhe pragjet

4.1 Shërbimet e operatorëve të infrastrukturës digjitale do të përcaktohen sipas:

a) numrit të subjekteve të lidhura me infrastruktura "*Internet Exchange Point*" (IXP), që përcaktohet si:

i. shërbim/infrastrukturë e rëndësishme nga 1–5 subjekte;

ii. shërbim/infrastrukturë kritike mbi 5 subjekte.

4.2 Shërbimi i shpërndarjes së përmbajtjes sipas numrit të abonentëve përcaktohet si:

a) shërbim/infrastrukturë e rëndësishme nga 1,000–5,000 abonentë;

b) shërbim/infrastrukturë kritike mbi 5,000 abonentë.

4.3 Shërbimi publik i komunikimeve elektronike sipas numrit të abonentëve përcaktohet si:

a) shërbim/infrastrukturë e rëndësishme nga 1,000–5,000 abonentë;

b) shërbim/infrastrukturë kritike mbi 5,000 abonentë.

Skema




Figura 14. Klasifikimi i shërbimeve të sektorit të infrastrukturës digjitale

¹⁴ Referencë: ligji nr. 97/2013 (i ndryshuar).

KREU XII

SEKTORI I MENAXHIMIT TË SHËRBIMEVE TIK

1. Sektori i menaxhimit të shërbimeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) luan një rol kyç në mbështetjen dhe optimizmin e operacioneve të biznesit dhe shërbimeve publike përmes zgjidhjeve teknologjike. Ky sektor përfshin ofrimin e shërbimeve IT, menaxhimin e sistemeve të rrjeteve, sigurinë kibernetike, zhvillimin e aplikacioneve dhe mbështetjen teknike. Menaxhimi efektiv i shërbimeve TIK ndihmon organizatat të rrisin efikasitetin, të përmirësojnë produktivitetin e të sigurojnë vazhdimësinë e operacioneve. Përparimet në teknologji dhe praktikat më të mira të menaxhimit të shërbimeve kanë bërë të mundur që ky sektor të jetë një faktor kyç në inovacionin dhe transformimin digjital, duke i lejuar bizneset dhe institucionet publike të reagojnë shpejt ndaj ndryshimeve në treg dhe kërkesave të klientëve.

2. Klasifikimi, bazuar në kriteret e përgjithshme sektoriale

2.1 Shërbimet TIK të ofruara nga subjekte të kategorizuara si biznes i madh, sipas ligjit në fuqi, drejt infrastrukturave kritike ose të rëndësishme të informacionit¹⁵, klasifikohen automatikisht si shërbim kritik.

3. Për sektorin e menaxhimit të shërbimeve TIK nuk aplikohen kriteret e veçanta sektoriale.

Skema




Figura 15. Klasifikimi i shërbimeve të sektorit të menaxhimit TIK

KREU XIII

SEKTORI I ADMINISTRATËS PUBLIKE

I. Sektori i Administratës Publike përbëhet nga:

- a) administrata publike në nivel qendror;
- b) administrata publike në nivel rajonal;
- c) institucionet e pavarura.

II. Administrata publike në nivel qendror

Sektori i administratës publike në nivel qendror është përgjegjës për hartimin e zbatimin e politikave kombëtare, menaxhimin e burimeve publike dhe ofrimin e shërbimeve jetike për qytetarët. Ky sektor përfshin Kryeministrinë, ministritë, institucionet në varësi të Kryeministrit ose të ministrave, njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve, agjencitë autonome; administratën e prefektit, që punojnë për të siguruar mirëqenie, siguri dhe zhvillim ekonomik në shkallë kombëtare. Administrata publike në nivel

¹⁵ Infrastruktura kritike dhe të rëndësishme të përcaktuara sipas ligjit nr. 25/2024, “Për sigurinë kibernetike”.

qendror luan një rol thelbësor në hartimin politikave, legjislacionit, mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve dhe koordinimin e programeve publike.

2. Klasifikimi, bazuar në kriteret e përgjithshme sektoriale

2.1 Shërbimet e ofruara drejt institucioneve të klasifikuara si infrastruktura informacioni të rëndësishme ose kritike klasifikohen automatikisht si shërbim kritik.

2.2 Shërbimi i ofruar nga portali unik qeveritar klasifikohet automatikisht si shërbim kritik.

3. Klasifikimi, bazuar në kriteret e veçanta sektoriale dhe pragjet

3.1 Shërbimet unike të ofruara nga institucionet publike për qytetarët, subjektet ose institucionet e infrastrukturave të informacionit të rëndësishëm ose/dhe kritik, përcaktohen, si më poshtë vijon:

a) për qytetarët:

i. shërbim/infrastrukturë, nga i/e cili/a përfitojnë 10,000–50,000 qytetarë, klasifikohet si shërbim i rëndësishëm;

ii. shërbim/infrastrukturë, nga i/e cili/a përfitojnë mbi 50,000 qytetarë, klasifikohet si shërbim kritik;

b) për subjektet:

i. shërbim/infrastrukturë, nga i/e cili/a përfitojnë 3,000–10,000 subjekte klasifikohet si shërbim i rëndësishëm;

ii. shërbim/infrastrukturë, nga i/e cili/a përfitojnë mbi 10,000 biznese, klasifikohet si shërbim kritik.

Skema




Figura 16. Klasifikimi i shërbimeve të administratës publike në nivel qendror

III. Administrata publike në nivel rajonal

1. Sektori i administratës publike në nivel rajonal është përgjegjës për menaxhimin dhe zbatimin e politikave dhe të shërbimeve publike brenda rajoneve të caktuara, duke vepruar si një lidhje kyçe ndërmjet qeverisë qendrore e komuniteteve lokale. Ky sektor përfshin autoritetet rajonale, këshillat dhe agjencitë qendrore, të cilat koordinojnë zhvillimin ekonomik, infrastrukturën, arsimin, shëndetësinë dhe shërbimet sociale për të përmbushur nevojat specifike të rajonit. Administrata publike rajonale luan një rol kritik në përshtatjen e politikave kombëtare me karakteristikat dhe prioritetet lokale, duke siguruar një shpërndarje më efektive dhe të drejtë të burimeve. Efikasiteti dhe bashkëpunimi në këtë nivel janë thelbësorë për përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve dhe për nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm rajonal.

2. Për subjektet e administratës publike në nivel rajonal nuk aplikohen kriteret e përgjithshme.

3. Klasifikimi, bazuar në kriteret e veçanta sektoriale dhe pragjet

3.1 Shërbimet e ofruara nga institucionet e administratës publike në nivel rajonal identifikohen dhe klasifikohen sipas kriterëve dhe pragjeve, si më poshtë vijon:

- a) numri i qytetarëve që marrin shërbime në vit (në formë direkte ose indirekte) përcaktohet si:
 - i. shërbim/infrastrukturë, nga i/e cili/a përfitojnë 10,000–50,000 qytetarë, klasifikohet si shërbim i rëndësishëm;
 - ii. shërbim/infrastrukturë, nga i/e cili/a përfitojnë mbi 50,000 qytetarë, klasifikohet si shërbim kritik.
- b) numri i subjekteve që marrin shërbime të lidhura me sistemin e taksimit në vit përcaktohen, si:
 - i. shërbim/infrastrukturë, nga i/e cili/a përfitojnë 3,000–10,000 subjekte, klasifikohet si shërbim i rëndësishëm;
 - ii. shërbim/infrastrukturë, nga i/e cili/a përfitojnë mbi 10,000 subjekte, klasifikohet si shërbim kritik.

Skema




Figura 17. Klasifikimi i shërbimeve të subjekteve të administratës publike në nivel rajonal

IV. Institucionet e pavarura

1. Institucionet e pavarura përfshijnë një grup organesh dhe autoritetesh, që veprojnë të pavarura nga qeveria për të siguruar mbikëqyrjen, transparencën e llogaridhënien në qeverisje dhe në sektorët e ndryshëm të shoqërisë. Këto institucione kanë rol kritik në mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të qytetarëve, zbatimin e ligjit, ruajtjen e konkurrencës së drejtë dhe garantimin e proceseve demokratike. Funksionimi i pavarur dhe i paanshëm i këtyre institucioneve është jetik për forcimin e shtetit të së drejtës, përmirësimin e qeverisjes dhe besimin e publikut në institucionet demokratike.

2. Klasifikimi, bazuar në kriteret e përgjithshme sektoriale

2.1 Shërbimet e ofruara nga institucionet e pavarura, ligjzbatuese, ligjvënëse dhe të sigurisë, cenimi i informacioneve të të cilave do të ndikonte në interesin e në sigurinë e publikut, si edhe në sigurinë kombëtare, klasifikohen automatikisht si shërbime kritike.

3. Për sektorin e institucioneve të pavarura nuk aplikohen kriteret e veçanta sektoriale.

Skema




Figura 18. Klasifikimi i shërbimeve të institucioneve të pavarura

KREU XIV SEKTORI I HAPËSIRËS

1. Sektori i hapësirës është një fushë dinamike dhe e avancuar teknologjikut, që përfshin eksplorimin, studimin dhe shfrytëzimin e hapësirës. Ky sektor përfshin agjencitë hapësinore, kompanitë private, institutet kërkimore dhe universitetet, që punojnë së bashku për të zhvilluar teknologji të avancuara, të tilla, si: satelitët dhe anijet kozmike. Aktivitetet në sektorin e hapësirës përfshijnë misionet e eksplorimit planetar, vëzhgimin e Tokës, komunikimin global dhe hulumtimet shkencore në mjedisin unik të mikrogravitetit. Sektori i hapësirës është gjithashtu një motor i rëndësishëm për inovacionin dhe zhvillimin ekonomik, duke hapur mundësi të reja për industrinë dhe kërkimin shkencor.

2. Klasifikimi, bazuar në kriteret e përgjithshme sektoriale

2.1 Shërbimi i ofruar nga institucionet/subjektet e lidhura me gjeohapësirën klasifikohet automatikisht si shërbim kritik.

3. Për sektorin e hapësirës nuk aplikohen kriteret e veçanta sektoriale.

Skema




Figura 19. Klasifikimi i shërbimeve të sektorit të hapësirës

KREU XV SEKTORI ARSIMOR

1. Sektori arsimor është një komponent thelbësor i zhvillimit shoqëror dhe ekonomik, duke ofruar mundësi për të mësuar dhe zhvilluar aftësi, që ndihmojnë individët të arrijnë potencialin e tyre të plotë. Ky sektor përfshin institucionet e arsimit parauniversitar dhe të lartë, si dhe qendrat e trajnimit profesional dhe arsimimit të vazhdueshëm.

2. Sektori arsimor përfshin këto shërbime:

a) Shërbimin arsimor parauniversitar dhe të lartë.

3. Për sektorin arsimor nuk aplikohen kriteret e përgjithshme sektoriale.

4. Klasifikimi, bazuar në kriteret e veçanta sektoriale dhe pragjet

4.1 Shërbimi arsimor parauniversitar dhe i lartë identifikohet dhe klasifikohet, si më poshtë vijon:

a) Numri aktiv i nxënësve/studentëve të regjistruar për të gjitha nivelet arsimore/ciklet e studimit përcaktohet si:

i. shërbim/infrastrukturë, nga i/e cili/a përfitojnë 3,000 – 10,000 nxënës/studentë, klasifikohet si shërbim i rëndësishëm;

ii. shërbim/infrastrukturë, nga i/e cili/a përfitojnë mbi 10,000 nxënës/studentë, klasifikohet si shërbim kritik.

Skema




Figura 20. Klasifikimi i shërbimeve të sektorit të arsimit

KREU XVI SEKTORI I TURIZMIT

1. Sektori i turizmit është një pjesë vitale e ekonomisë globale, që përfshin udhëtimin dhe eksplorimin e destinacioneve të ndryshme për qëllime rekreative, kulturore dhe biznesi. Ky sektor përfshin hotelet, restorantet, agjencitë e udhëtimit, transportin dhe atraksionet turistike, të cilat punojnë së bashku për të ofruar përvoja të paharrueshme për vizitorët. Turizmi luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik, duke krijuar vende pune, duke nxitur investimet dhe duke përmirësuar infrastrukturën lokale.

2. Sektori i turizmit përfshin këto shërbime:

- a) shërbimi i ofruar nga agjencitë e udhëtimit;
- b) shërbimi i ofruar nga operatori turistik;
- c) shërbimi i ofruar nga ofruesi i shërbimeve turistike;
- ç) shërbimi i ofruar nga strukturat akomoduese.

3. Për sektorin e turizmit nuk aplikohen kriteret e përgjithshme sektoriale.

4. Klasifikimi, bazuar në kriteret e veçanta sektoriale dhe pragjet

4.1 Shërbimi i ofruar nga strukturat akomoduese, nga i cili kanë përfituar mbi 50,000 klientë¹⁶/vit, klasifikohet si shërbim i rëndësishëm.

5. Nuk klasifikohen si shërbime kritike dhe të rëndësishme shërbimet e sektorit të transportit rrugor, si më poshtë:

- 5.1 Shërbimi i ofruar nga agjencitë e udhëtimit;
- 5.2 Shërbimi i ofruar nga operatori turistik;
- 5.3 Shërbimi i ofruar nga ofruesi i shërbimeve.

¹⁶ Në rastin e sektorit të turizmit, klient do të konsiderohet qytetari, i cili shpenzon të paktën një natë qëndrim.

Skema




Figura 21. Klasifikimi i shërbimeve të sektorit të turizmit

KREU XVII

SEKTORI POSTAR DHE SHËRBIMET E KORRIERIT

1. Sektori postar dhe shërbimet e korrierit luajnë një rol thelbësor në lehtësimin e komunikimit dhe të shkëmbimit të mallrave në nivel lokal e global. Ky sektor përfshin ofrimin e shërbimeve tradicionale postare, të dërgesave ekspres dhe të logjistikës së avancuar, duke përfshirë shpërndarjen e letrave, të pakove dhe të dokumenteve. Kompanitë postare dhe të korrierit, si operatorët publikë dhe privatë, përdorin rrjete të gjera infrastrukturore dhe teknologji moderne për të garantuar shpërndarje të shpejtë, të sigurt e të besueshme. Përmirësimet në teknologji dhe inovacionet në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit kanë bërë të mundur që ky sektor të përshtatet me kërkesat në rritje të tregtisë elektronike dhe globalizimit.

2. Sektori postar përfshin:

- a) shërbimin postar;
- b) shërbimin universal postar.

3. Klasifikimi, bazuar në kriteret e përgjithshme sektoriale

3.1 Shërbimi universal postar klasifikohet automatikisht si shërbim kritik.

4. Klasifikimi, bazuar në kriteret e veçanta sektoriale dhe pragjet

4.1 Shërbimet postare përcaktohen sipas:

- a) numrit vjetor të transaksioneve postare, referuar vitit paraardhës, që përcaktohet si:
 - i. shërbim/infrastrukturë e rëndësishme nga 1,000,000–2,500,000 transaksione/vit;
 - ii. shërbim/infrastrukturë kritike mbi 2,500,000 transaksione/vit;

Skema




Figura 22. Klasifikimi i shërbimeve të sektorit postar

KREU XVIII

SEKTORI I MENAXHIMIT TË MBETJEVE

1. Sektori i menaxhimit të mbetjeve është jetik për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin publik, duke përfshirë grumbullimin, transportin, përpunimin, riciklimin dhe asgjësimin e mbetjeve të ngurta dhe të lëngshme. Ky sektor përfshin një gamë të gjerë shërbimesh dhe infrastrukture, nga landfillet dhe impiantet e djegies deri te qendrat e riciklimit dhe trajtimit të mbetjeve të rrezikshme. Inovacionet teknologjike dhe praktikat e qëndrueshme kanë përmirësuar efikasitetin e menaxhimit të mbetjeve, duke reduktuar ndikimin mjedisor dhe duke promovuar riciklimin e ripërdorimit të materialeve. Menaxhimi efektiv i mbetjeve është thelbësor për ruajtjen e burimeve natyrore, uljen e ndotjes dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për komunitetet, duke kontribuar në një mjedis më të pastër e më të qëndrueshëm.

2. Sektori i menaxhimit të mbetjeve përfshin këto shërbime:

- a) shërbimin e grumbullimit të mbetjeve;
- b) shërbimin e asgjësimit të mbetjeve;
- c) shërbimin e ripërdorimit dhe të riciklimit të mbetjeve;
- ç) transportimin e mbetjeve.

3. Klasifikimi, bazuar në kriteret e përgjithshme sektoriale

3.1 Shërbimi i grumbullimit të mbetjeve klasifikohet automatikisht si shërbim i rëndësishëm.

3.2 Shërbimi i ripërdorimit dhe riciklimit të mbetjeve klasifikohet automatikisht si shërbim i rëndësishëm.

4. Kriteret e veçanta sektoriale

4.1 Shërbimi i asgjësimit të mbetjeve identifikohet dhe klasifikohet, si më poshtë vijon:

- a) pesha maksimale e mbetjeve urbane të djegura (të incineruara) në tonë për 24 orë përcaktohet, si:
 - i. shërbim/infrastrukturë e rëndësishme nga 20–70 tonë;
 - ii. shërbim/infrastrukturë kritike mbi 70 tonë;
- b) pesha maksimale e mbetjeve spitalore të djegura (të incineruara) në ton për 24 orë përcaktohet, si:
 - i. shërbim/infrastrukturë e rëndësishme nga 1–5 tonë;
 - ii. shërbim/infrastrukturë kritike mbi 5 tonë.

5. Nuk klasifikohen si shërbime kritike dhe të rëndësishme shërbimet e sektorit të menaxhimit të mbetjeve, si më poshtë:

5.1 Shërbimi i transportimit të mbetjeve.

Skema




Figura 23. Klasifikimi i shërbimeve të sektorit të menaxhimit të mbetjeve

KREU XIX

SEKTORI I PRODHIMIT

1. Sektori i prodhimit është një shtyllë kryesore e ekonomisë globale, duke përfshirë transformimin e lëndëve të para në produkte të gatshme për konsumatorët dhe industrinë. Ky sektor përfshin një gamë të gjerë industrish, nga prodhimi i automjeteve dhe i elektronikës deri tek ushqimet e tekstilet dhe përdor teknologji të avancuara e procese inovative për të rritur efikasitetin dhe cilësinë e produkteve. Përmirësimet në automatizim, robotikë dhe inteligjencë artificiale kanë revolucionarizuar prodhimin, duke ulur kostot e duke përmirësuar produktivitetin.

2. Sektori i prodhimit përfshin këta nënsektorë:

- Nënsektori i prodhimit të pajisjeve mjekësore dhe pajisjeve mjekësore diagnostikuese *in-vitro*;
- Nënsektori i prodhimit të produkteve kompjuterike, elektronike dhe optike;
- Nënsektori i prodhimit të pajisjeve elektrike;
- Nënsektori i prodhimit të makinerive dhe pajisjeve n.e.c;
- Nënsektori i prodhimit të automjeteve, rimorkiove dhe gjysmërimorkiove.

3. Klasifikimi, bazuar në kriteret e përgjithshme sektoriale

3.1 Shërbimet për monitorimin e kontrollin e produkteve të mbrojtjes së bimëve ose plehërueset, që përfshijnë prodhimin, ruajtjen, përdorimin, klasifikohen automatikisht si shërbime të rëndësishme.

3.2 Shërbimet e prodhimit të produkteve ushqimore të ofruara nga subjektet tregtare të regjistruara në organin tatimor pranë Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj klasifikohen automatikisht si shërbime të rëndësishme.

3.3 Shërbimet për prodhimin e pajisjeve mjekësore dhe të pajisjeve mjekësore diagnostikuese *in-vitro*; për prodhimin e produkteve kompjuterike, elektronike dhe optike; prodhimin e pajisjeve elektrike, prodhimin e makinerive dhe pajisjeve; prodhimin e automjeteve, rimorkiove dhe gjysmërimorkiove; prodhimi i pajisjeve të tjera të transportit; klasifikohen automatikisht si shërbime të rëndësishme.

4. Për sektorin e prodhimit nuk aplikohen kriteret e veçanta sektoriale.

Skema




Figura 24. Klasifikimi i shërbimeve të sektorit të prodhimit

KREU XX

SEKTORI I OFRUESVE TË SHËRBIMEVE DIGJITALE

1. Sektori i ofruesve të shërbimeve digjitale përfshin kompani dhe organizata, që ofrojnë një gamë të gjerë shërbimesh dhe produkte përmes platformave digjitale, duke përfshirë internetin dhe pajisjet *mobile*. Ky sektor përfshin platformat e komunikimit dhe të rrjeteve sociale, shërbimet e ruajtjes së të dhënave në re, tregtinë elektronike, pagesat dhe portofolat elektronike, transmetimin mediatik, edukimin *on-line* dhe teknologjitë e informacionit.

2. Klasifikimi, bazuar në kriteret e përgjithshme sektoriale

2.1 Shërbimet e ofruara nga ofruesit e shërbimeve digjitale, të cilat afektojnë publikun, klasifikohen automatikisht të rëndësishme.

3. Për sektorin e ofruesit të shërbimeve digjitale nuk aplikohen kriteret e veçanta sektoriale.

Skema




Figura 25. Klasifikimi i shërbimeve të sektorit të ofruesit të shërbimeve digjitale

KREU XXI

SEKTORI I PRODHIMIT, I PËRPUNIMIT DHE I SHPËRNDARJES SË KIMIKATEVE

1. Sektori i prodhimit, i përpunimit dhe i shpërndarjes së kimikateve ka një rol të rëndësishëm në ekonominë globale dhe luan një rol kritik në shumë industri të tjera. Ky sektor është kyç për sektorë të tillë, si: bujqësia, farmaceutika, ndërtimi dhe prodhimi i energjisë. Megjithatë, për shkak të natyrës së ndjeshme dhe shpesh të rrezikshme të materialeve kimike që përfshihen, ky sektor kërkon një nivel të lartë të kujdesit dhe të mbikëqyrjes, veçanërisht për të garantuar mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe të mjedisit.

2. Sektori i prodhimit, i përpunimit dhe i shpërndarjes së kimikateve përfshin këto shërbime:

- a) shërbimin e prodhimit të kimikateve;
- b) shërbimin e tregimit të kimikateve;
- c) shërbimin e përdorimit të kimikateve;
- ç) shërbimin e regjistrimit të kimikateve.

3. Klasifikimi i bazuar në kriteret e përgjithshme sektoriale

3.1 Shërbimi i prodhimit të kimikateve klasifikohet automatikisht si i rëndësishëm.

3.2 Shërbimi i tregimit të kimikateve klasifikohet automatikisht si i rëndësishëm.

3.3 Shërbimi i përdorimit të kimikateve klasifikohet automatikisht si i rëndësishëm.

3.4 Shërbimi i regjistrimit të kimikateve klasifikohet automatikisht si i rëndësishëm.

Skema




Figura 26. Klasifikimi i shërbimeve të sektorit të prodhimit, të përpunimit e të shpërndarjes së kimikateve

SHTOJCA 1

SKEMA LOGJIKE – OSE

Përshkrim

Skema logjike “OSE” është një operacion themelor në logjikë dhe shkencë kompjuterike, që përdoret për të vlerësuar disa kushte ose deklarata. E shënuar me simbolin “V” ose fjalën “OSE”, ajo kthehet në të vërtetë, nëse të paktën njëri nga kushtet që lidh është i vërtetë, dhe në të pavërtetë, vetëm nëse të gjitha kushtet janë të pavërteta. Kjo skemë lejon krijimin e shprehjeve logjike komplekse, duke kombinuar deklarata më të thjeshta, duke mundësuar marrjen e vendimeve bazuar në skenarë të ndryshëm, ku çdo kusht i vetëm, që është i vërtetë, është i mjaftueshëm për të plotësuar kushtin e përgjithshëm.

i = shërbime

j = kriteret

n_i = numër mbi 1

n_j = numri i kriterëve mbi 1

Skema i referohet modelit matematikor, ku, në rast se një prej kriterëve e klasifikon shërbimin si kritik, atëherë automatikisht shërbimi klasifikohet si kritik dhe nuk vijohet më tej me klasifikimin e tij. Ndërkohë

që në rastet kur nga kriteri i plotësuar shërbimi klasifikohet si i rëndësishëm, kërkimi vijon më tej. Nëse nuk gjendet deri në fund të paktën një kriter kritik, atëherë automatikisht shërbimi klasifikohet si i rëndësishëm.




Figura 27. Skema logjike – OSE



VENDIM

Nr. 690, datë 6.11.2024

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
DHE PROCEDURAVE PËR LIDHJEN E
MARRËVESHJEVE TË VEÇANTA TË
BASHKËPUNIMIT MIDIS SUBJEKTEVE
PUBLIKE SHQIPTARE DHE
SUBJEKTEVE PUBLIKE DHE/OSE
PRIVATE TË EMIRATEVE TË
BASHKUARA ARABE, NË FUSHA,
PROJEKTE DHE PROGRAME
KONKRETE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 25, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Objekti dhe qëllimi

1. Objekt i këtij vendimi është përcaktimi i rregullave dhe i procedurave që do të ndiqen nga autoritetet dhe subjektet publike të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e marrëveshjes ndërkombëtare për bashkëpunimin ekonomik, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe (në vijim marrëveshja “EBA”), ratifikuar me ligjin nr. 145/2020, si dhe në zbatim të marrëveshjes për nxitjen dhe mbrojtjen e investimeve, të nënshkruar në Tiranë, më 15.10.2015, të miratuar me vendimin nr. 949, datë 25.11.2015, të Këshillit të Ministrave, në lidhje me bashkëpunimin e drejtpërdrejtë midis institucioneve publike të Republikës së Shqipërisë dhe sektorit publik dhe/ose privat të Emirateve të Bashkuara Arabe.

2. Qëllimi i këtij vendimi është zbatimi i detyrimeve të ndërmarra nga qeveria shqiptare, sipas parashikimeve të marrëveshjeve ndërkombëtare me Emiratet e Bashkuara Arabe, të përmendura në pikën 1, të këtij neni, si dhe arritja e kushteve më të mira financiare e teknike për institucionet publike në marrëdhëniet e bashkëpunimit, të lidhura në bazë të këtyre marrëveshjeve ndërkombëtare.

Neni 2

Fusha e zbatimit

Fusha e zbatimit të këtij vendimi janë të gjitha llojet e marrëveshjeve të veçanta për bashkëpunim në sektorë, fusha, programe dhe projekte konkrete, të cilat lidhen me fushat e bashkëpunimit, të përcaktuara bashkërisht dhe të parashikuara në nenet 2 e 3, të marrëveshjes EBA.

Neni 3

Institucionet përgjegjëse

1. Subjektet publike të këtij vendimi (në vijim “institucionet përgjegjëse”) janë të gjitha institucionet e administratës shtetërore, përfshirë institucionet në varësi të Kryeministrit ose të ministrave, e agjencitë autonome, si dhe entet publike e shoqëritë tregtare shtetërore, brenda fushës së përgjegjësisë të të cilave përfshihet fusha/programi/projekti konkret i bashkëpunimit, sipas marrëveshjes EBA.

2. Për zbatimin e një projekti konkret mund të jenë përgjegjës më shumë se një institucion. Në këtë rast, për zbatimin e këtij vendimi, institucionet përgjegjëse do të krijojnë grupe të përbashkëta pune. Grupet e përbashkëta të punës ngrihen me vendimmarrjen e titullarëve të institucioneve përgjegjëse përkatëse dhe përbëhen nga punonjës të këtyre institucioneve dhe, sipas rastit, edhe nga ekspertë të jashtëm.

Neni 4

Titullari i institucionit përgjegjës

1. Titullari i institucionit përgjegjës për fushën/ sektorin përkatës është përgjegjës për koordinimin, ndjekjen dhe mbikëqyrjen e të gjithë procesit të zbatimit të marrëveshjes. Në këtë funksion, titullari i institucionit është konkretisht përgjegjës, për:

a) koordinimin e brendshëm ndërmjet njësive përgjegjëse brenda institucionit, si dhe koordinimin me institucionet e tjera shtetërore dhe publike, në rastet kur është i nevojshëm;

b) monitorimin dhe raportimin e progresit të zbatimit të marrëveshjes EBA dhe të marrëveshjeve, të memorandumëve të mirëkuptimit, të protokolleve, të kontratave të veçanta të tjera, të lidhura në bazë të marrëveshjes EBA;



c) përfshirjen e ekspertëve të jashtëm, të kontraktuar me marrëveshje shërbimi dhe sektorëve të tjerë të interesuar, kur është e nevojshme;

ç) raportimin periodik në Këshillin e Ministrave për progresin e zbatimit të marrëveshjes dhe për çdo çështje që mund të kërkojë ndërhyrje në nivelin e qeverisë.

2. Pas identifikimit të projekteve konkrete të fushës në komitetin e përbashkët, të krijuara nga marrëveshja EBA, titullari i institucionit përgjegjës dhe/ose zyrtarët e autorizuar prej tij fillojnë negociatat me organet dhe autoritetet kompetente të EBA-s ose me sektorin publik apo privat të saj, me qëllim zbatimin e projekteve dhe programeve konkrete të bashkëpunimit, duke respektuar termat dhe kushtet e përcaktuar në marrëveshjen EBA.

3. Pas përfundimit të negociatave, në rastin kur pala përfaqësuese e EBA-s përfaqësohet nga një subjekt publik, drafti i marrëveshjes i paraqitet për mendim ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme dhe ministrisë përgjegjëse për financat, kur ka efekte financiare, si dhe çdo ministrie apo institucioni që ka lidhje me zbatimin e marrëveshjes. Drafti përfundimtar i marrëveshjes nënshkruhet nga titullari i institucionit përgjegjës apo çdo zyrtar i autorizuar prej tij.

4. Institucioni përgjegjës, në negociim me palën tjetër, mund të kryejë rishikime të rregullta të marrëveshjes/kontratës për të siguruar përputhshmërinë me objektivat dhe për të bërë ndryshimet e nevojshme për përmirësimin e saj.

Neni 5

Identifikimi i projekteve

1. Në rastet kur kërkesa për bashkëpunim në një fushë ose për një program/projekt konkret vjen nga pala e EBA-s, si dhe në rastet kur nevoja për bashkëpunim për një projekt të caktuar identifikohet nga pala shqiptare, ministria përgjegjëse, për llogari të saj apo me kërkesë të institucioneve të tjera përgjegjëse, të parashikuara në këtë vendim, drejton nëpërmjet kanaleve zyrtare kërkesën për mbledhjen e komitetit të përbashkët, sipas marrëveshjes EBA, me qëllim prezantimin e projektit të propozuar dhe diskutimin për mundësinë dhe rrugët e realizimit të tij, përfshirë shqyrtimin e rrugëve ligjore dhe procedurave, sipas legjislacionit të zbatueshëm.

2. Komiteti i përbashkët shqyrton rëndësinë dhe përputhshmërinë e projektit me marrëveshjen EBA

dhe dakordëson për përfshirjen e projektit konkret në listën e projekteve specifike, që zhvillohen sipas marrëveshjes EBA.

3. Komiteti, me pëlqimin e ndërsjellë të palëve, mund të ftojë përfaqësues të institucionit përgjegjës me ekspertizën e nevojshme, në lidhje me çështjet që do të diskutohen dhe të zhvillojë takime të përbashkëta me sektorin publik apo privat.

Neni 6

Kërkesa për bashkëpunim

1. Në vijim të vendimmarrjes së komitetit të përbashkët, sipas marrëveshjes EBA, projektet e dakordësuara u bëhen zyrtarisht me dije palëve ndërshtetërore, autoriteteve dhe subjekteve publike apo private, përmes kanaleve diplomatike për bashkëpunim në një fushë ose për një program/projekt konkret.

2. Në institucionin përgjegjës shqiptar, në fushën e përgjegjësisë të të cilit bie projekti, me marrjen e dërgimit të vendimmarrjes së komitetit të përbashkët, ngrihet një grup pune, i përbërë nga punonjës të institucionit, ekspertë të fushës përkatëse, të paraqitur në kërkesë, të cilët kryejnë një vlerësim paraprak për nevojën dhe mundësinë e bashkëpunimit konkret në fushën/projektin e caktuar dhe përfshirjen e këtij projekti në procedurat e bashkëpunimit, të parashikuara nga marrëveshja EBA.

3. Pas kryerjes së vlerësimit paraprak, institucioni përgjegjës shqiptar kërkon nga subjekti publik/privat, i cili ka dërguar kërkesën pranë komitetit të përbashkët, të paraqesë, në bazë të dokumentacionit, një përshkrim të hollësishëm të fushës së bashkëpunimit apo të projektit të propozuar, objektivat, burimet e financimit, përfitimet e parashikuara për palët dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm për të vlerësuar rëndësinë dhe realizueshmërinë e projektit.

4. Brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve kalendarike nga paraqitja e kërkesës për bashkëpunim, nëse grupi i punës kryen një vlerësim pozitiv të mundësisë së bashkëpunimit në fushën/projektin konkret, institucioni përgjegjës njofton ministrinë përkatëse dhe i kërkon mbledhjen e komitetit të përbashkët, sipas marrëveshjes EBA, për të diskutuar mundësinë e realizimit të bashkëpunimit të propozuar.



5. Nëse grupi i punës vlerëson që kërkesa nuk është e realizueshme ose nuk përmbush kriteret paraprake të nevojshme, sipas pikës 1, të nenit 8, institucioni përgjegjës informon subjektin publik apo privat EBA, duke dhënë një arsyetim të refuzimit të tij.

Neni 7

Hapat proceduralë

1. Pas identifikimit dhe përfshirjes së projektit konkret në listën e projekteve specifike, që zhvillohen sipas marrëveshjes EBA, si dhe plotësimit të dokumentacionit të kërkuar, në zbatim të këtij vendimi, institucionet përgjegjëse lidhin marrëveshje/kontratë me subjektet publike apo private EBA.

2. Titullarët e institucioneve përgjegjëse janë të autorizuar të ngrenë, rast pas rasti, për çdo lloj forme konkrete bashkëpunimi, të parashikuar në marrëveshjen EBA, grupin e hartimit të termave të negocimit dhe grupin e negocimit të kontratës.

3. Në rastin e shoqërive tregtare me kapital shtetëror apo subjekteve të tjera publike, të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre ekzekutive vendimmarrëse në mënyrë kolegjiale, miratimi i raportit të negocimit kryhet nga këshilli mbikëqyrës i shoqërisë apo bordi/organi kolegjial vendimmarrës i subjektit publik.

4. Grupi i hartimit të termave të negocimit dhe grupi i negocimit të kontratës, të cilat caktohen, rast pas rasti, në varësi të projektit konkret dhe institucioneve përgjegjëse të përfshira, do të përbëhen nga jo më pak se 5 (pesë) persona, përfaqësues të institucioneve përgjegjëse dhe, nëse vlerësohet e nevojshme, ekspertë të jashtëm.

5. Grupi i negocimit është i ngarkuar për të vlerësuar dhe negociuar kërkesat e drejtuara dhe ofertat e paraqitura për projektet dhe programet konkrete. Në çdo rast, numri i anëtarëve duhet të jetë tek. Grupi i negocimit rregullohet dhe funksionon sipas termave të negocimit të projektit konkret, të parashikuar në aktin e ngritjes së tij, dhe merr vendime me shumicën e anëtarëve të tij të pranishëm.

6. Nuk mund të marrin pjesë në grupin e negocimit personat që kanë konflikt interesi me projektin konkret ose me palën EBA, sipas ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

7. Afatet konkrete të negocimit për zbatimin e një projekti konkret, të bazuar në marrëveshjen EBA dhe në marrëveshje të tjera të veçanta, të lidhura sipas saj, miratohen, rast pas rasti, në aktin e ngritjes së grupit të hartimit të termave të negocimit.

8. Grupi i negocimit përgatit raportin përfundimtar të negocimit, i cili i dorëzohet titullarit të institucionit përgjegjës për miratim.

9. Në çdo rast, përfundimi i procedurës i bëhet me dije komitetit të përbashkët ose nënkomiteteve të krijuara, sipas marrëveshjes EBA.

Neni 8

Kriteret e negocimit

1. Në fillim të procedurës, për të hyrë në negociatë, palët në negocim sigurojnë që subjekti publik apo privat EBA plotëson kriteret e mëposhtme:

a) subjekti nuk është në proces falimentimi dhe/ose likuidimi;

b) subjekti nuk është dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

c) kapitalet dhe asetet e subjektit nuk janë objekt i procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm nga ana e shërbimit përmbarrimor;

ç) subjekti i ka përmbushur rregullisht detyrimet në lidhje me pagesat e taksave dhe të tatimeve dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore;

d) subjekti ka stabilitet ekonomik/kapacitet financiar për financimin e zhvillimit të projektit konkret;

dh) subjekti, vetë apo nëpërmjet nënkontraktuesve, siguron eksperiencë në projekte të ngjashme në lidhje me zhvillimin e projektit konkret;

e) subjekti paraqet planin e zhvillimit të detajuar të projektit, i cili përfshin, ndër të tjera, vlerën e investimit, burimin dhe mënyrën e financimit, plan-biznesin, partneritete të mundshme, grafikun, fazat dhe afatet e ekzekutimit të investimeve për zhvillimin e projektit, vlerësimin e ndikimit social, ekonomik, mjedisor e strategjik të projektit dhe strukturën organizative të drejtimit.

2. Subjektet publike apo private të EBA-s duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet, që nuk lëshohen në vendin e origjinës, subjektet duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe do të



konsiderohet se nuk plotësojnë kriteret për të hyrë në negociim. Në çdo rast, institucioni përgjegjës ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga subjekti publik apo privat, si më sipër, ose t'i kërkojë subjektit sqarime dhe dokumente mbështetëse.

Neni 9

Kriteret e vlerësimit të grupit të negociimit

1. Gjatë dhe pas zhvillimit të negociatave, me qëllim miratimin e projektit dhe subjektit publik apo privat EBA, grupi i negociimit duhet të kryejë vlerësimin e plotësimit të kushteve dhe kriterëve, si më poshtë vijon:

a) projekti i propozuar nga subjekti EBA është në përputhje me objektivat strategjike të institucionit përgjegjës dhe kontribuon në përmbushjen e nevojave të identifikuar nga grupi i punës, i ngritur brenda institucionit për zbatimin e marrëveshjes EBA, sipas nenit 3, të këtij vendimi;

b) projekti ka një vlerë të shtuar ekonomike dhe siguron një kthim të kënaqshëm të investimit për institucionin përgjegjës;

c) projekti është financiarisht i qëndrueshëm dhe përmbush të gjitha kërkesat e kostos dhe financimit të parashikuara;

ç) projekti është i qëndrueshëm teknikisht, duke përmbushur standardet dhe specifikimet teknike të kërkuara;

d) projekti paraqet inovacion dhe përdorim të teknologjive të reja, që çojnë në përmirësim të efikasitetit dhe reduktim të kostove;

dh) projekti përfshin një vlerësim të detajuar të rreziqeve dhe propozon masa për menaxhimin dhe minimizimin e tyre. Rreziqet që lidhen me projektin duhet të jenë të pranueshme dhe të menaxhueshme nga grupi i negociimit dhe institucionet publike;

e) projekti përfshin masa për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm dhe për të minimizuar ndikimet negative në komunitet dhe mjedis;

ë) subjekti përmbush kriteret e nevojshme për pajisjen me leje dhe licenca për zhvillimin e projektit konkret, duke përfshirë kapacitetet teknike, operacionale e financiare;

f) subjekti garanton raportim dhe llogaridhënie të veprimtarisë së tij tek institucioni përgjegjës, lidhur me zhvillimin dhe zbatimin e projektit konkret;

g) subjekti garanton respektimin e konfidentalitetit të të dhënave dhe marrjen e masave të

veçanta të sigurisë, në rast se kërkohet nga projekti dhe marrëdhënia konkrete;

gj) subjekti plotëson kriteret e besueshmërisë, pastërtisë së figurës dhe reputacionit të lartë në sektorin, objekt marrëveshjeje.

2. Në termat e negociimit të projekteve konkrete mund të parashikohen kushte dhe kriteret e tjera, që lidhen me qëllimet e posaçme të institucioneve përgjegjëse.

Neni 10

Lidhja e kontratave

1. Pas miratimit të raportit të negociimit nga titullari/titullarët e institucionit/institucioneve përgjegjës/e, draftmarrëveshja ose kontrata e dakordësuar mes palëve, sipas rastit, u dërgohet për mendim Ministrisë së Financave, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Avokaturës së Shtetit, si dhe çdo institucioni tjetër shtetëror, të interesuar për zbatimin e marrëveshjes/kontratës. Mendimi i këtyre institucioneve jepet brenda 7 (shtatë) ditëve dhe, nëse çështjet e ngritura prej tyre janë të një natyre thelbësore, të lidhura me objektin, me legjitimitetin apo me zbatueshmërinë e kontratës, këto çështje negocohen edhe një herë me palën EBA dhe, pas negociimit, ndiqet përsëri procedura e marrjes së mendimit para lidhjes së kontratës.

2. Draftmarrëveshja ose kontrata nënshkruhet nga titullari/titullarët e institucionit/ institucioneve përgjegjëse, sipas këtij vendimi.

Neni 11

Dispozita të fundit

Ngarkohen institucionet e administratës shtetërore, përfshirë institucionet në varësi të Kryeministrit ose ministrave, dhe agjencitë autonome e entet publike dhe shoqëritë tregtare shtetërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



VENDIM
Nr. 691, datë 6.11.2024

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
TË VEÇANTA QË ZBATOHEN PËR
KONTRATËN E MËSIMIT TË
PROFESIONIT DHE PËRCAKTIMIN E
PAGËS MINIMALE PËR MËSIMIN E
PROFESIONIT NË ARSIMIN DHE
FORMIMIN PROFESIONAL NË
FORMËN E DYFISHTË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 18, pika 1, dhe 111, pika 3, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 22, të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
TË PËRGRJITHSHME

Neni 1
Objekti

Qëllimi i këtij vendimi është përcaktimi i rregullave të veçanta që zbatohen për kontratën e mësimit të profesionit dhe përcaktimi i pagës minimale për mësimin e profesionit në arsimin dhe formimin profesional në formën e dyfishtë në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2
Përkufizime

Në kuptim të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. **“Nxënës që mëson profesionin”**, nxënësi që ndjek një nga kualifikimet profesionale të niveleve 2 deri në 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (në vijim, KSHK), që ofrohet në formën e dyfishtë, i cili nënshkruan kontratën e mësimit të profesionit me një punëdhënës.

2. **“Kontrata e mësimit të profesionit”** kontrata që lidhet ndërmjet punëdhënësit dhe nxënësit për mësimin e profesionit nëpërmjet

formës së dyfishtë, në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës.

3. **“Mentori”**, personi i ngarkuar nga punëdhënësi për të mbikëqyrur, trajnuar e vlerësuar nxënësin, që mëson profesionin gjatë zbatimit të pjesës praktike të skeletkurrikulave të programeve për përfitimin e kualifikimeve në formën e dyfishtë që ofron.

4. **“Mësuesi i kulturës profesionale, përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratës për mësimin e profesionit”**, mësuesi i caktuar nga institucioni ofrues i arsimit dhe formimit profesional, për të ndjekur e mbështetur nga afër veprimtarinë e nxënësve, që mësojnë profesionin në procesin mësimor në shkollë dhe në vendin e punës për mësimin e profesionit.

5. **“Kujdestari i praktikës profesionale”**, një specialist i arsimit profesional, i cili angazhohet në zbatimin e kontratës për mësimin e profesionit nëpërmjet formës së dyfishtë, në mbështetje të institucionit ofrues të arsimit dhe formimit profesional.

6. **“Paga minimale për mësimin e profesionit”**, pagesa mujore që kryen punëdhënësi për nxënësin, që mëson profesionin përgjatë kohëzgjatjes së kontratës së mësimit të profesionit për kualifikimin përkatës.

Neni 3

**Kualifikimet profesionale, që ofrohen
përmes formës së dyfishtë**

Kualifikimet e përfuara nëpërmjet formës së dyfishtë të arsimit dhe formimit profesional janë kualifikimet e niveleve 2, 3, 4 e 5 të KSHK-së, të ofruara në përputhje me shkronjën “c”, të pikës 3, të nenit 16, të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

KREU II

**RREGULLAT E VEÇANTA PËR
ZBATIMIN E KONTRATËS PËR MËSIMIN E
PROFESIONIT**

Neni 4

**Përzgjedhja e punëdhënësit për zbatimin e
kontratës së mësimit të profesionit**

1. Përzgjedhja e punëdhënësit për zbatimin e kontratës së mësimit të profesionit bëhet në bazë të kritereve të mëposhtme:



a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) për të paktën 3 (tre) vjet;

b) Ka të paktën 2 (dy) punëmarrës të deklaruar;

c) Ushtron veprimtari në fusha që lidhen me kualifikimet/drejtimet/profilet që ofron institucioni ofrues i arsimit dhe formimit profesional;

ç) Vetëdeklaron që ka në dispozicion një punëmarrës në rolin e mentorit për ofrimin e kualifikimeve në formën e dyfishtë, i cili plotëson kriteret e parashikuara në nenin 7, të këtij vendimi;

d) Vetëdeklaron që është i gatshëm të vendosë në dispozicion infrastrukturën e nevojshme, si: pajisje, materiale pune dhe vende vakante pune, në funksion të zbatimit të kontratës së punës për mësimin e profesionit;

dh) Deklaron vendet vakante të punës për mësimin e profesionit.

2. Institucioni ofrues i arsimit dhe formimit profesional, pasi vlerëson dhe zgjedh punëdhënësin, që plotëson kriteret e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, kërkon miratimin për lidhjen e marrëveshjes në Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe të Aftësive. Kjo e fundit informon rregullisht ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional, dhe Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, duke u vënë në dispozicion listën e punëdhënësve, me të cilët kanë lidhur marrëveshje institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional dhe të nxënësve që mësojnë profesionin.

Neni 5

Të drejtat dhe detyrimet e nxënësit që mëson profesionin

1. Nxënësi, që ka mbushur moshën 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjeç, i regjistruar në një institucion ofrues të arsimit dhe formimit profesional, në një program për përfitimin e kualifikimit profesional në formën e dyfishtë, nënshkruan kontratën për mësimin e profesionit me një nga punëdhënësit, që ky institucion ka marrëveshje bashkëpunimi. Kontrata për mësimin e profesionit duhet të jetë në përputhje me rregullat e përcaktuara në Kodin e Punës, si dhe me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e fëmijëve në punë, sipas formatit të përcaktuar me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional.

2. Nxënësi përfiton nga punëdhënësi një pagesë për punën e kryer në funksion të mësimin të profesionit, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

3. Nxënësi që mëson profesionin ka të gjitha të drejtat e detyrimit ligjorë si çdo nxënës, në përputhje me legjislacionin për arsimin dhe formimin profesional. Nxënësit që mësojnë profesionin, që nuk e kanë mbushur moshën madhore, gëzojnë mbrojtjen ligjore, që gëzon çdo nxënës e çdo fëmijë që punon në Republikën e Shqipërisë.

Neni 6

Të drejtat dhe detyrimet e institucioneve ofruese të arsimit dhe formimit profesional

Institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional kanë të drejtat dhe detyrimet, si më poshtë vijon:

1. Aplikojnë përpara fillimit të vitit shkollor për ofrimin e kualifikimeve nëpërmjet formës së dyfishtë, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin dhe formimin profesional.

2. Identifikojnë, përzgjedhin, në bazë të kriterëve të paracaktuara në këtë vendim, dhe lidhin marrëveshje bashkëpunimi me punëdhënësit, me të cilët do të bashkëpunojnë.

3. Hartojnë, mbajnë dhe përditësojnë dosjet e punëdhënësve, që plotësojnë kriteret për të ofruar kualifikimet në formën e dyfishtë.

4. Mbikëqyrin mbarëvajtjen e zbatimit të programit profesional përkatës të punëdhënësit, ku zbatohet kontrata e mësimin të profesionit në formën e dyfishtë.

5. Koordinojnë e dokumentojnë vlerësimin e vazhduar dhe vlerësimin përfundimtar të nxënësve, që mësojnë profesionin gjatë mësimin të profesionit në formën e dyfishtë.

6. Trajnojnë dhe certifikojnë mentorët, pa pagesë, sipas programit të hartuar nga Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, miratuar nga ministri përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional.

7. Lëshojnë certifikatë profesionale dhe suplementin përkatës në përfundim të studimeve, sipas niveleve të KSHK-së, në arsimin dhe formimin profesional në formën e dyfishtë.

8. Caktojnë një mësues të kulturës profesionale, përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratës për mësimin e profesionit.



9. Në mbështetje të zbatimit të kontratës së mësimi të profesionit nëpërmjet formës së dyfishtë, kanë të drejtën të angazhojnë, sipas nevojave, specialistë të arsimit e të formimit profesional në rolin e kujdestarit për praktikën profesionale, me përvojë profesionale/ mësimdhënieje, në moshë pune ose në pension, në përputhje me rregullat e procedurat e parashikuara në legjislacionin në fuqi. Një profesionist, që angazhohet si kujdestar për praktikën profesionale nëpërmjet formës së dyfishtë, duhet të ketë:

a) përfunduar arsimin e mesëm profesional ose të lartë në fushën e kualifikimit profesional, që ofrohet nëpërmjet arsimit të dyfishtë;

b) mbi 20 (njëzet) vjet përvojë pune në fushën e kualifikimit profesional, që ofrohet nëpërmjet arsimit të dyfishtë.

10. Procedurat për planifikimin e zbatimit të arsimit dhe formimit profesional në formën e dyfishtë nga institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional, duke përfshirë edhe detyrat e përgjegjësitë e mësuesit të kulturës profesionale, përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratës për mësimin e profesionit, si dhe të kujdestarit të praktikës profesionale, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional.

Neni 7

Të drejtat dhe detyrimet e punëdhënësit

Punëdhënësit kanë këto të drejta dhe detyrime:

1. Bashkëpunojnë me institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional, nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit për ofrimin e kualifikimeve profesionale në formën e dyfishtë.

2. Nënshkruajnë dhe garantojnë zbatimin e kontratës për mësimin e profesionit me nxënësin, që mëson profesionin. Kontrata hyn në fuqi jo më herët se dita e parë e vitit shkollor për kualifikimin përkatës dhe zgjat deri në momentin kur nxënësi, që mëson profesionin, i nënshtrohet provimit të nivelit për kualifikimin përkatës.

3. I paguajnë një pagesë mujore nxënësit që mëson profesionin për punën, që kryen gjatë mësimi të profesionit, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

4. Caktojnë një anëtar të stafit si mentor, i cili duhet të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë

profesionale dhe mund të udhëheqë deri në 5 (pesë) nxënës, që mësojnë profesionin, i cili kryen detyrat e mëposhtme:

a) Është përgjegjës për zbatimin e kontratës së mësimi të profesionit, për mbarëvajtjen e programit për përfitimin e kualifikimeve nëpërmjet formës së dyfishtë, si dhe për vlerësimin e vazhduar e vlerësimin përfundimtar të nxënësve në koordinim e në bashkëpunim me institucionet partnere, ofruese të arsimit dhe formimit profesional;

b) Duhet të kryejë, jo më vonë se 3 (tre) muaj pas nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet punëdhënësit dhe institucionit ofrues të arsimit dhe formimit profesional për ofrimin e arsimit të dyfishtë, një trajnim për udhëheqjen e nxënësve, që mësojnë profesionin, të cilët ndjekin formën e dyfishtë për përfitimin e kualifikimeve profesionale;

c) Bashkëpunon me mësuesin e kulturës profesionale, përgjegjës për zbatimin e kontratës së mësimi të profesionit, të caktuar nga institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional. Në rastin kur nxënësi që mëson profesionin nuk e ka mbushur moshën madhore, mentori mban kontakt të rregullt me kujdestarin ligjor të fëmijës.

5. Sigurojnë vendin e punës, mjetet dhe infrastrukturën e nevojshme për zbatimin e kontratës për mësimin e profesionit për çdo nxënësi që mëson profesionin.

6. Marrin përsipër certifikimin e nxënësve që mësojnë profesionin për rregullat e sigurimit teknik në punë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

7. Dokumentojnë realizimin e kontratës dhe kryejnë vlerësimin e nxënësit, që mëson profesionin përgjatë punës për mësimin e profesionit.

8. Lëshojnë vërtetim/letër reference në fund të realizimit me sukses së kontratës për mësimin e profesionit.

9. Ndërpresin, në çdo kohë, në përputhje me parashikimet e dispozitave të Kodit të Punës, marrëdhënien e punës me nxënësin që mëson profesionin, nëse ky i fundit nuk respekton detyrimet e marra përsipër prej tij, në bazë të kontratës së punës për mësimin e profesionit.

10. Zbatojnë dispozitat ligjore, të cilat rregullojnë punën e punëmarrësit të grupmoshës 16 (gjashtëmbëdhjetë) deri në 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç, si dhe dispozitat e legjislacionit për mbrojtjen e fëmijëve në punë, në rastet kur nxënësi që mëson



profesionin nuk ka mbushur 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç në momentin e nënshkrimit të kontratës.

Neni 8

Transferimi i nxënësve që mësojnë profesionin

1. Nxënësit që mësojnë profesionin kanë të drejtë të transferohen nga një punëdhënës, që zbaton kontratën e mësimi të profesionit në formën e dyfishtë, në një tjetër, si dhe nga një program për përfitimin e kualifikimit profesional në formën e dyfishtë në një program me bazë shkollën brenda të njëjtit kualifikim.

2. Procesi i transferimit të nxënësve që mësojnë profesionin përcaktohet në udhëzimet përkatëse për transferimin e nxënësve në arsimin dhe formimin profesional.

KREU III

MASA DHE PROCEDURA E KRYERJES SË PAGESËS PËR NXËNËSIN QË MËSON PROFESIONIN

Neni 9

Paga minimale e mësimi të profesionit

1. Paga minimale për mësimin e profesionit në shkallë vendi është sa 30 (tridhjetë) % e pagës minimale mujore në shkallë vendi, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi.

2. Paga për nxënësin që mëson profesionin për punën e kryer gjatë zbatimit të kontratës për mësimin e profesionit nuk mund të jetë më e vogël se paga minimale për mësimin e profesionit.

Neni 10

Pagesa për nxënësin që mëson profesionin

1. Punëdhënësi kryen pagesën individuale të nxënësit që mëson profesionin, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Paga për nxënësin që mëson profesionin, deri në moshën 25 (njëzet e pesë) vjeç, nuk përlllogaritet si e ardhur e familjes, në kuptimin e ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, në vlerësimin e kërkesës së familjes për trajtim me ndihmë ekonomike.

KREU IV

DISPOZITA TË TJERA

Neni 11

Institucione të tjera përgjegjëse

Institucione të tjera përgjegjëse për zbatimin dhe respektimin e kontratës së mësimi të profesionit janë:

1. Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, i cili inspekton zbatimin e legjislacionit të punës, të sigurisë dhe shëndetit në punë te punëdhënësi dhe nxënësit që mësojnë profesionin në mjediset e punës, gjatë zbatimit të kontratës së punës për mësimin e profesionit.

2. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, e cila monitoron zbatimin e të drejtave të nxënësve që mësojnë profesionin, nën moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç, në vendin e punës, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 12

Dispozita të fundit

1. Ngarkohet ministri përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional të miratojë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga publikimi i këtij vendimi, udhëzimin për përcaktimin e procedurave për planifikimin dhe zbatimin e arsimit e formimit profesional në formën e dyfishtë nga institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional, duke përfshirë edhe detyrat e përgjegjësive të mësuesit të kulturës profesionale, përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratës për mësimin e profesionit dhe të kujdestarit të praktikës profesionale.

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive dhe institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



VENDIM

Nr. 692, datë 7.11.2024

**PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË
PREFEKTIT TË QARKUT TË FIERIT**

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Arben Çuko emërohet prefekt i qarkut të Fierit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku**

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 176 lekë

